



СРЕДНОРОЧНА ПРОГРАМА ЗА РАБОТА НА  
**ФОНДОТ ЗА ИНОВАЦИИ И  
ТЕХНОЛОШКИ РАЗВОЈ ЗА  
2021-2023 ГОДИНА**

---

СКОПЈЕ, ДЕКЕМВРИ 2020 ГОД.

PROGRAMI AFATMESËM PËR PUNËN E  
FONDIT TË INOVACIONEVE DHE  
TË ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK PËR VITIN  
2021-2023  
SHKUP, DHJETOR, VITI 2020

## PËRMBAJTJA

HYRJA.....	5
VIZIONI, MISIONI DHE QËLLIMET AFATGJATA.....	Error! Bookmark not defined.
GRUPI I SYNUAR .....	7
VEPRIMTARIA E FONDIT .....	Error! Bookmark not defined.
FINANCIMI .....	Error! Bookmark not defined.
<b>SHTYLLA 1 – MBËSHTETJA FINANCIARE E SEKTORIT PRIVAT</b>	
<b>SEKTORI.....</b>	<b>10</b>
– Mbështetja financiare e sektorit privat nëpërmjet Planit të Rritjes Ekonomike të Qeverisë së RMV-së, shtylla III.....	10
– Mbështetja financiare e sektorit privat nëpërmjet Projektit të Zhvillimit të Aftësive dhe mbështetjes së inovacioneve të financuara nëpërmjet huamarrjes nga Banka Botërore.....	14
– Mbështetje e vetëpunësimit nëpërmjet zhvillimit të bizneseve inovative "INgrupa".....	16
– Forcimi i kapaciteteve të Fondit nëpërmjet mbështetjes teknologjike nga ana e Bankës Botërore.....	16
– Zhvillimi i masave të reja dhe instrumentet e mbështetjes së sektorit privat .....	17
<b>SHTYLLA 2 - MBËSHTETJA E BIZNESEVE</b>	
<b>ZHVILLIMI.....</b>	<b>17</b>
– Mbështetja teknike për Aplikuesit dhe Programi i mentorimit për përdoruesit.....	17
– Programi zhvillimor i mentorimeve të synuara.....	18
– Inovacioni korporativ.....	18
– Partneritetet.....	18
o Bashkëpunimi me partnerë vendor.....	19
o Bashkëpunimi me partnerë ndërkombëtarë.....	20
– MBËSHTETJE NË ZHVILLIMIN E BIZNESEVE.....	23
– SFIDAT TEMATIKE.....	23
o Ekonomia e gjelbër .....	23
o Sipërmarrësia sociale.....	24
o Digjitalizimi i sektorit publik .....	24

o Agroteknologji/ Agri Tech.....	25
o Zinxhiri i furnizimit / Supply chain.....	25
<b>SHTYLLA 3 - STARTAP EKOSISTEME.....</b>	<b>25</b>
<b>SHTYLLA 4 – SISTEMI HELIKS I TREFISHTË/KATËRFISHTË.....</b>	<b>28</b>
– ARSIMI DHE TRAJNIMI.....	30
o Sfidë për hulumtuesit e rinj.....	30
o Mbështetja e programeve arsimore globale të suksesshme, që e nxisin të menduarit kritik, inovacionin, kreativitetin dhe SHTIAM te nxënësit dhe të rinjtë.....	30
o Krijimi i Programit për sipërmarrësi praktike dhe mundësi në startap ekosistemin për nxënësit e shkollave të mesme.....	31
o Mbështetja e posaçmërisë teknologjike dhe shkencore dhe sipërmarrësia te nxënësit dhe të rinjtë.....	31
o Platforma e rrjetëzimit dhe mobilizimit, dhe racionalizimi i burimeve .....	31
– BASHKËPUNIMI NDËRMJET BASHKËSISË HULUMTUESE SHKENCORE DHE AKADEMIKE DHE SEKTORIT PRIVAT .....	32
– MBËSHTETJA FINANCIARE .....	32
o Kupon inovacioni.....	32
o Grante bashkëpunuese.....	33
o Mbështetje financiare për vendosjen dhe zbatimin e praktikave inovative në bujqësi.....	33
o Mobiliteti i burimeve njerëzore me kualifikim të lartë: Mbështetja për angazhimin e magjistrantëve dhe doktorantëve në sektorin privat.....	33
– INFRASTRUKTURA E INOVACIONIT.....	33
o Parku teknologjik shkencor dhe Zyra Nacionale e Transferimit të Teknologjive.....	33
o Qendrat e posaçmërisë “FAB LABS”.....	34
<b>SHTYLLA 5 – FIZHT EFEKTI.....</b>	<b>34</b>
– Analiza e portofolit të përdoruesve të Fondit nga sektori privat.....	34
– Analiza e performancave financiare të punës së përdoruesve të Fondit.....	34
– Digjitalizimi i portofolit dhe aktivitetet e monitorimit të përdoruesve.....	35
– MARKETINGU DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN.....	36
– ORGANIZIMI.....	37
– MBIKËQYRJA DHE VLERËSIMI (monitorimi i përdoruesve).....	38

Bazuar në nenin 28, paragrafi 1 dhe neni 30, paragrafi 6, nënparagrafi 4 të Ligjit të Veprimtarisë Inovative (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr.79/13, 137/13, 41/14, 44/15, 6/16, 53/16, 190/16 dhe 64/18) dhe nenit 20, paragrafi 2, nënparagrafi 4, të Statutit të Fondit të Inovacioneve dhe të Zhvillimit Teknologjik nr. 01-347/1 2015, me datë 26.5.2015, Këshilli drejtues i Fondit, me propozimin e drejtorit të Fondit, në seancën e mbajtur në vitin \_\_\_\_\_ miratoi

**PROGRAM AFATMESËM TË PUNËS**  
**SË FONDIT TË INOVACIONEVE DHE TË ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK**  
**PËR PERIUDHËN 2021–2023**

## HYRJE

Fondi i Inovacioneve dhe i Zhvillimit Teknologjik (në tekstin e mëtejshëm: "Fondi") është person juridik i themeluar me Ligjin e Veprimtarisë Inovative, i regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë me numër vendimi 30120130043573, datë 16.12.2013 me numrin amëz 6920098.

Fondi synon të promovojë dhe inkurajojë aktivitetin inovativ, përmirësimin e qasjes në shërbimet financiare për inovacion, zhvillimin e infrastrukturës së inovacionit dhe zhvillimit teknologjik, dhe zhvillimin e partneriteteve. Synimi kryesor është nxitja e zbatimit të inovacioneve tek kompanitë vendore, duke siguruar burime shtesë për financimin e inovacioneve, si bazë për ndërtimin e një ekonomie konkurruese të bazuar në njohuri.

Ne e arrijmë këtë qëllim duke mbështetur krijimin dhe zbatimin e politikave zhvillimore, duke mbështetur miratimin e legjislacionit përkatës dhe proceseve të tjera të rëndësishme shoqërore, që kanë ndikim në faktorët inkurajues për pozicionimin e suksesshëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke ofruar grante të bashkëfinancuara për inovacione dhe zhvillime teknologjike, ndihmë teknike për kompanitë, për të lehtësuar qasjen në fondet rajonale, investimet aksionare dhe mezanin dhe ndihma financiare për hulumtime.

Sipas përcaktimeve të tij programore dhe politikës zhvillimore, Fondi mund të marrë pjesë në bashkëfinancimin e programeve dhe aktiviteteve të tjera, nëse ato organizohen dhe financohen nga organizata ndërkombëtare, institucione dhe organe financiare dhe persona të tjerë juridikë dhe fizikë të huaj dhe vendor.

Me zbatimin e synimeve të përcaktuara, ne kontribuojmë në mënyrë aktive në zhvillimin e përshpejtuar teknologjik bazuar në transferimin e njohurive, kërkimin zhvillimor dhe inovacionin që kontribuojnë në rritjen dhe zhvillimin ekonomik, por edhe në përmirësimin e klimës së biznesit për zhvillimin e aftësisë konkurruese të sipërmarrjeve.

## VIZIONI, MISIONI DHE QËLLIMET AFATGJATA

Vizioni - Fondi i Inovacioneve dhe i Zhvillimit Teknologjik duhet të jetë një institucion qendror për mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik duke inkurajuar inovacionin dhe zhvillimin teknologjik. Për të realizuar këtë vizion, ne aplikojmë disa iniciativa të reja për zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve financiare dhe jofinanciare për sipërmarrjet, si dhe edukim dhe mbështetje sistematike dhe moderne për të gjithë faktorët përkatës në shoqëri.

Misioni - nxitja dhe mbështetja e aktivitetit inovativ midis sipërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme dhe të sapo themeluara për zhvillim të përshpejtuar teknologjik që bazohet në transferimin e njohurive, hulumtimeve zhvillimore dhe inovacioneve që kontribuojnë në zhvillimin dhe rritjen ekonomike, për edhe në përmirësimin e klimës së biznesit për zhvillimin e aftësisë konkurruese të kompanive.

Investimi në potencialin njerëzor dhe krijimi i kushteve të favorshme për zhvillimin e një ekosistemi inovativ me heliks të trefishtë/katërfishtë, që çon në transformimin e ekonomisë nacionale në kontekstin e rritjes së qëndrueshme nëpërmjet një ekonomie të bazuar në njohuri, ku inovacioni përfaqëson një shtytës bazë të zhvillimit ekonomik dhe një faktor të rëndësishëm për rritjen e konkurrencës së kompanive vendase.

**Prioritetet dhe synimet:**

- qasje të përmirësuar në shërbimet financiare për inovacione dhe zhvillim teknologjik,
- promovimin dhe inkurajimin e veprimtarisë së inovacionit,
- krijimi i një sistemi efikas heliks i trefishtë/katërfishtë me përfshirje dhe mbështetje aktive të të gjitha segmenteve – institucioneve publike, komunitetit akademik dhe shkencor, industrisë dhe qytetarëve,
- inkurajimi i aktivitetit inovativ nëpërmjet të gjitha niveleve të arsimit dhe trajnimit,
- inkurajimi i bashkëpunimit ndërmjet komunitetit akademik dhe industrisë për të intensifikuar transferimin e njohurive dhe transferimin e teknologjive,
- ndërgjegjësimi për rëndësinë e inovacionit për konkurrencën e ekonomisë vendore, dhe për zhvillimin shoqëror.

Qëllimi ynë kryesor është të nxisim inovacionin duke ofruar burime shtesë financimi, si një kontribut në ndërtimin e një ekonomie konkurruese të bazuar në njohuri.

Qëllimet e përcaktuara zbatohen nëpërmjet instrumenteve ekzistuese dhe masave mbështetëse, dhe punojmë në zhvillimin e masave të reja për të mbështetur inovacionin dhe zhvillimin teknologjik.

Fondi do të ndërtojë partneritete me palë të tjera, për realizimin e qëllimeve të përbashkëta.

Realizimi i qëllimeve të lartpërmendura kërkon integritet dhe zhvillim institucional dhe organizativ, dhe zhvillim të institucionit. Kjo nënkupton sisteme dhe procedura efikase, burime njerëzore të dedikuara dhe profesionale dhe burime të qëndrueshme financimi.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij Programi afatmesëm të punës, është të inkurajojë dhe mbështesë aktivitetin inovativ dhe zhvillimin teknologjik në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ky program përmban komponentët bazë të zhvillimit, realizimi i të cilëve është planifikuar në periudhën 2021 - 2023, parashikon drejtimet e përgjithshme si synime prioritare, masat që duhet të ndërmerren për realizimin e tyre dhe aktivitetet, të cilat me zbatimin e përpiktë nga punonjësit dhe me financimin e duhur, do të sigurojë jo vetëm realizimin e misionit dhe vizionit të Fondit, por do të përfaqësojë edhe një themel për ndërtimin e një ekonomie konkurruese të bazuar në njohuri.

## GRUPI I SYNUAR:

- **Përdoruesit e drejtpërdrejtë:**
  - Sipërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme
  - Institucionet arsimore, të arsimit sipëror dhe shkencore
  - Shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet
  - Persona të tjerë juridikë dhe fizikë të përcaktuar në dispozitat e akteve nënligjore përkatëse
  
- **Përdoruesit indirekt**
  - Institucionet publike
  - Sipërmarrjet e mëdha
  - Të gjithë pjesëmarrësit në procesin arsimor (nxënës, studentë, mësues, prindër, personel akademik, etj.)
  - Qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Strategjia nacionale për inovacion, Strategjia për specializim inteligjent (në fazë zhvillimore), Projekti për zhvillim të aftësive dhe inovacionit i financuar nga Banka Botërore, Plani për rritje ekonomike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (masat nga Shtylla 3), Strategjia e arsimit 2018-2025, dhe Plani i veprimit, Strategjia industriale e Republikës së Maqedonisë së Veriut 2018-2027, me Planin e veprimit dhe dokumentet tjera strategjike nacionale lidhur me zhvillimin e arsimit dhe ekonomisë në sferën e inovacionit dhe zhvillimit teknologjik, janë bazë për përgatitjen të këtij Programi afatmesëm të punës.

## VEPRIMTARIA E FONDIT

Detyrat themelore:

- financimi, përgatitja, realizimi dhe zhvillimi i programeve, projekteve dhe aktiviteteve tjera në fushën e zbatimit të politikës së inovacionit dhe mbështetjes së sektorit privat;
- punët profesionale dhe të tjera që kanë të bëjnë me sigurimin e mjeteve në Fondin, menaxhimin e atyre fondeve dhe përdorimin e tyre;
- ndërmjetësimi në financimin e veprimtarisë së inovacionit nga mjetet e organizatave ndërkombëtare, institucioneve dhe organeve financiare, si dhe personave juridikë e fizikë



vendor dhe të huaj, veçanërisht në fushën e shkencës dhe teknologjisë, në pajtim të prioritetëve të përcaktuara në strategjinë e inovacionit;

- mbajtjen e një baze të dhënash për përdoruesit e mjeteve të akorduara nga Fondi, të dhëna identifikuese për subjektet të cilave u janë miratuar mjetet, programet, projektet dhe aktivitetet e tjera në fushën e veprimtarisë inovative të financuara nga Fondi, si dhe të dhënat e nevojshme dhe mjetet financiare në dispozicion për realizimin e tyre;
- nxitjen dhe hyrjen në bashkëpunim me institucionet financiare ndërkombëtare dhe vendase, por edhe me persona të tjerë juridikë dhe fizikë, për shkak të financimit të veprimtarisë së inovacionit, në pajtim me politikën e inovacionit, planet dhe programet e tjera strategjike, si dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;
- pjesëmarrje në ngritjen e Zyrës Nacionale për Transferimin e Teknologjisë, për të mbështetur dhe inkurajuar bashkëpunimin ndërmjet universiteteve dhe industrisë;
- pjesëmarrja në ngritjen e një Parku të Shkencës dhe Teknologjisë, me qëllim mbështetjen e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet universiteteve dhe sektorit privat;
- përzgjedhja e një shoqërie për administrimin e fondeve private me thirrje publike, e cila do të administrojë me mjetet e Fondit të destinuara për realizimin e instrumenteve të investimeve aksionare dhe mezanin;
- themelimin e një Fondi për Investimet Aksionare dhe Mezanin, dhe miratimin e një statuti dhe prospekti të Fondit për Investimet Aksionare dhe Mezanin, dhe
- monitorimin dhe evaluimin e projekteve për të cilat janë ndarë mjete, me qëllim të zhvillimit të shoqërisë sipërmarrëse në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Fondi përmbush detyrat e tij duke ndarë burime financiare për:

- sigurimin e shërbimeve dhe kapitalit fillestar për themelimin dhe rritjen e shoqërive tregtare nëpërmjet dhënies së mjeteve financiare për projekte inovative;
- dhënien e granteve të bashkëfinancuara për komercializimin e inovacioneve, zhvillimin teknologjik, kuponëve të inovacionit;
- nxitja e investimeve private dhe financimi i projekteve të zhvillimit dhe/ose inovacionit në të gjitha fazat e zhvillimit nëpërmjet kapitalit të vet, dhe nëpërmjet kombinimit të kapitalit pronësor dhe kredive, nëpërmjet sigurimit të burimeve të favorshme kredie dhe garanci për investitorët, dhe
- mbështetje për krijimin e fondeve private duke investuar mjete ose duke garantuar fitimin nga mjetet e investuara; dhe
- nxitja e inovacionit në fushat prioritare të shkencës dhe teknologjisë në pajtim me strategjinë e inovacionit.

## FINANCIMI

Fondi fiton të ardhura nga:

- mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- mjetet në vlerë prej 1% të mjeteve të përgjithshme nga Programi për mbështetjen financiare të zhvillimit rural;
- mjetet nga Programi për mbështetjen financiare të zhvillimit rural mbi shumën e përcaktuar në nënparagrafin paraprak, në lartësinë e mjeteve të përcaktuara në Programin për mbështetjen financiare të zhvillimit rural për inovacion, kërkim dhe zhvillim, transferim të teknologjive, shtrirja teknologjike, akseleratorët e biznesit dhe teknologjisë në fushën e bujqësisë, pylltarisë, menaxhimit të ujërave dhe zhvillimit rural;
- donacione, kontribute, dhurata dhe ndihma;
- të ardhura nga komercializimi i inovacionit (rojalti);
- mjetet e fituara në bazë të shitjes së pjesëmarrjeve që Fondi për Investimet Ekuiti dhe Mezanin dhe/ose fondi privat i zotëron në shoqëri tregtare dhe sipërmarrje të tjera;
- të ardhurat e krijuara në bazë të bashkëpunimit ndërkombëtar dypalësh dhe shumëpalësh për programe, projekte dhe aktivitete të tjera në fushën e veprimtarisë inovative;
- të ardhurat nga administrimi i mjeteve monetare të lira të Fondit, dhe
- burime të tjera, në pajtim me ligjin.

Pjesa më e madhe e të ardhurave të Fondit, të cilat do të investohen nëpërmjet këtyre instrumenteve, janë mjete nga Buxheti i RMV-së për zbatimin e Planit të rritjes ekonomike dhe nga kredia nga Banka Botërore nëpërmjet Projektit për Zhvillimin e Aftësive dhe Inovacioneve.

Mjetet për mbështetje financiare për inovacion dhe zhvillim teknologjik për NMVM-të do të ndahen nëpërmjet një thirrjeje publike.

Projeksionet për dinamikën e publikimit të thirrjeve publike, shuma totale vjetore e mjeteve për dhënien (kontraktimin), si dhe mjetet e nevojshme financiare për realizimin e kontratave të nënshkruara janë zhvendosur në Shtojcën 1 dhe Shtojcën 2 të këtij Informacioni.

Sipas dinamikës aktuale, të gjitha mjetet e parashikuara nga Projekti për Zhvillimin e Aftësive dhe Inovacioneve do të kontraktohen deri në fund të afatit të kredisë - Prill 2021.

Mjetet për mbështetjen financiare të inovacionit dhe zhvillimit teknologjik për NMVM-të, të përcaktuara me instrumentet e mësipërme ndahen sipas kriterëve dhe procedurave të rregulluara me rregullore të veçanta të Fondit të Inovacioneve dhe të Zhvillimit Teknologjik, përveç masës 5 e cila zbatohet në vazhdimësi.

Mjetet për pagesat e tyre do të sigurohen nga kredia e Bankës Botërore, mjetet buxhetore të siguruara nga Plani i rritjes ekonomike, të ardhurat nga Programi i zhvillimit rural dhe buxheti bazë i fondit.

#### SHTYLLA 1 - MBËSHTETJA FINANCIARE E SEKTORIT PRIVAT

- **Mbështetje financiare për sektorin privat nëpërmjet Planit të rritjes ekonomike të Qeverisë së RMV-së, Shtylla III**

Fondi, si bartës i shtyllës së tretë të Planit të rritjes ekonomike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për mbështetjen e zhvillimit të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (në tekstin e mëtejshëm: NMVM-të), në koordinim me Zyrën e Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Kabinetit të zëvendëskryetarit të Qeverisë, përgjegjës për punët ekonomike dhe koordinimin me departamentet ekonomike, do të vazhdojnë të punojnë në aktivitetet që kanë të bëjnë me zbatimin e Shtyllës 3 të Planit të rritjes ekonomike. Bëhet fjalë për masa për nxitjen e investimeve, eksportit dhe konkurrencës së ekonomisë së Maqedonisë, përkatësisht:

(a) Masa 1: Mbështetja e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme me tendencë rritjeje të shpejtë ("Gazelat");

Mjetet nga kjo masë përdoren për grante të bashkëfinancuara për zhvillim teknologjik të kompanive, që mbulojnë deri në 30% të shpenzimeve të pranueshme direkte të kërkuarit në projekte investuese, por jo më shumë se 10.000.000 denarë.

**Mbështetja ofrohet për aktivitetet dhe kostot e mëposhtme të investimeve:**

- pranimi dhe zbatimi i rregulloreve teknike europiane në lidhje me sigurinë e produkteve;
- përgatitjet për marrjen e certifikatave të cilësisë;
- aktivitetet për analizën, përgatitjen, përvetësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale dhe intelektuale;
- përgatitjen dhe zbatimin e aktiviteteve për përmirësimin e efikasitetit energjetik;
- përgatitja e elaborateve për mbrojtjen e mjedisit;
- përgatitja dhe ngritja e sistemeve të menaxhimit të mbeturinave;
- futja e sistemeve të informacionit;
- kostot për mbështetje teknike (ekspertizë), bazuar në një profil të dorëzuar më parë të ekspertëve vendor dhe/ose të jashtëm që do të angazhohen në projekt;
- kostot që lidhen me procedurat para organizatave, instituteve kërkimore-shkencore, kompanive dhe organizatave ndërkombëtare që lidhen me blerjen e certifikatave të cilësisë, blerjen e patentave dhe të drejtave të tjera të pronësisë intelektuale, si dhe dokumente të tjera që lidhen me veprimtari investimi, të cilat lëshohen nga një subjekt i certifikuar;

- kostot për shërbimet kontraktuese për kërkim dhe zhvillim (p.sh. testimi, shërbimet laboratorike, etj.);
- kostot për blerjen ose marrjen me qira të pajisjeve, mjeteve të TI-së dhe llojeve të tjera të mjeteve bazë për NMVM-të, të lidhura drejtpërdrejt me zbatimin e projektit të zhvillimit teknologjik;
- kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e projektit, përveç pagave dhe prokurimet nga ndërmarrjet publike vendore.

Mbështetja financiare mund të përdoret në një periudhë *deri në 18* muaj, nga dita e miratimit të projektit.

(b) Masa 2: Mbështetje e veçantë (shtesë) financiare për NMVM-të;

Mjetet nga kjo masë përdoren për grante të bashkëfinancuara për zhvillim teknologjik të kompanive që mbulojnë deri në 30% të shpenzimeve direkte të pranueshme të përdoruesit, por jo më shumë se 5.000.000 denarë.

Mbështetja ofrohet për aktivitetet dhe kostot e mëposhtme të investimeve:

- mbështetje teknike nga ekspertë të jashtëm për përgatitjen e planeve strategjike afatmesme dhe afatgjata;
- trajnime për planifikimin afatmesëm të biznesit (plani i biznesit trevjeçar);
- përgatitja e projekteve zhvillimore për lidhje biznesi dhe vendosja e bashkëpunimit biznesor (në një periudhë prej 3 deri në 5 vjet) me investitorët e huaj dhe me ndërmarrjet vendase;
- përmirësimi i strukturës organizative për të përballuar rritjen e kompanisë;
- trajnime të specializuara menaxheriale - programe për zhvillimin edhe të aftësive të ekipeve menaxheriale;
- trajnimi për njohjen e talentëve (liderët e ardhshëm) dhe krijimi i programeve të zhvillimit të talentëve (liderët e ardhshëm);
- trajnime për planifikimin dhe kontrollin e kostove;
- prokurimi ose zhvillimi i softuerit specifik në lidhje me përmirësimin e strukturës dhe performancës organizative, ose përmirësimin e proceseve operacionale që do të rrisin produktivitetin dhe/ose procesin e planifikimit;
- kostot për mbështetje teknike (ekspertizë), bazuar në një profil të dorëzuar më parë të ekspertëve vendor dhe/ose të jashtëm që do të angazhohen në projekt;
- kostot lidhur me përgatitjen dhe realizimin e trajnimeve;
- kosto të tjera që lidhen me zbatimin e një plani për përmirësimin e strukturës organizative të kërkuesit;
- kostot për prokurimin dhe/ose zhvillimin e pajisjeve, softuerëve, mjeteve të TI-së dhe llojeve të tjera të burimeve bazë të TIK-ut për NMVM-të, që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e projektit të zhvillimit teknologjik;
- kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e projektit, përveç pagave dhe prokurimet nga ndërmarrjet publike vendore.

Mbështetja financiare mund të përdoret në një periudhë *deri në 18* muaj, nga dita e miratimit të projektit.

(c) Masa 3: Mbështetje financiare për përmirësimin e inovacionit;

Mjetet nga kjo masë përdoren për grante të bashkëfinancuara për zhvillimin dhe zbatimin e zgjidhjeve inovative për aplikuesit, duke mbuluar deri në 70% të shpenzimeve direkte, por jo më shumë se 20.000.000 denarë.

Mbështetja ofrohet për aktivitetet dhe kostot e mëposhtme të investimeve:

- përpunimin e aspekteve tekniko-teknologjike në zhvillimin dhe prezantimin e produkteve apo shërbimeve të reja;
- përmirësimin e ndjeshëm të produkteve ose shërbimeve ekzistuese;
- krijimin e koleksioneve të reja të modës;
- prodhimin e dizajnit industrial ose ridizajnimin e produkteve;
- prodhimin e ambalazheve të reja;
- përpunimin e planeve të marketingut (analiza e tregut, analiza e konkurrencës, hulumtimi i produktit, shitjet, etj.);
- përmirësimin e procesit ekzistues ose futja e një procesi të ri prodhimi;
- pagat bruto (për personat e punësuar të përdoruesit dhe anëtarët e konsorciumit) shuma e të cilave duhet të korrespondojë me praktikën e vendosura të përfituesit përpara fillimit të projektit;
- prokurimin dhe/ose dhënien me qira të pajisjeve dhe materialeve harxhuese për kërkime dhe zhvillim;
- shërbimet e kërkimit dhe zhvillimit të nënkontraktuara (p.sh. testimi, shërbimet laboratorike, etj.);
- punësimin e ekspertëve/këshilltarëve për kërkime dhe zhvillim;
- punësimin e konsulentëve për nevoja të tjera që lidhen drejtpërdrejt me rezultatet e pritshme të projektit (ekspertiza në lidhje me menaxhimin e inovacionit, menaxhimin financiar, mobilizimin e mjeteve, zhvillimin e biznesit, marketingun, punët ligjore, mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe të tjera);
- përgatitjen dhe dorëzimin e kërkesës për patentë, mbrojtje të markës tregtare dhe/ose dizajnit industrial dhe aktiviteteve të tjera përgatitore për regjistrimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale;
- kostot e marketingut dhe mbështetje të zyrës dhe biznesit në një shumë maksimale prej 10% të buxhetit të përgjithshëm të projektit.

Mbështetja financiare mund të përdoret në një periudhë *deri në 24* muaj, nga dita e miratimit të projektit.

(d) Masa 4: Mbështetje financiare për përmirësimin profesional dhe praktikë për të rinjtë e sapopunësuar

Mjetet nga kjo masë përdoren për grante të bashkëfinancuara për zhvillim teknologjik të kompanive që mbulojnë deri në 30% të shpenzimeve për trajnim dhe përmirësimin profesional të të rinjve të sapopunësuar, por jo më shumë se 1.000.000 denarë.

Mbështetja nga kjo masë jepet për përmirësimin profesional dhe/ose praktikë për personat deri në moshën 29 vjeç, të punësuar nga kërkuesi për të paktën 6 muaj para dorëzimit të kërkesës për mbështetje financiare. Mbështetja përfshin mbulimin e:

- kostove për trajnimin profesional dhe praktikën për një të ri të sapopunësuar te kërkuesi (përfshirë Fast Track Management Programme);
- kostove për trajnimin dhe praktikën profesionale për një të ri të sapopunësuar në një kompani dhe/ose organizatë tjetër që ofron këtë lloj shërbimi;
- kostove që lidhen me përgatitjen dhe zbatimin e një plani për forcimin e aftësive profesionale dhe teknike;
- shpenzimeve të udhëtimit, akomodimit dhe ushqimit brenda dhe jashtë vendit, nëse programi për përmirësim profesional dhe/ose praktikë zbatohet jashtë vendbanimit të punonjësit;
- kostove për aplikim, kuotizim dhe kompensimet e tjera për pjesëmarrje në programin për përmirësim profesional dhe/ose praktikë të arkëtuara nga organizatori (një subjekt i ndryshëm nga kërkuesi);
- shpenzimeve për përgatitjen dhe dhënien e provimeve, për marrjen e certifikatave dhe dokumenteve të tjera për një program dhe/ose praktikë të zbatuar me sukses;
- kostove të tjera direkte që lidhen me organizimin dhe/ose pjesëmarrjen në program për përmirësim profesional dhe/ose praktikë.

Mbështetja e përgjithshme sipas kësaj mase për një kërkues mund të përdoret për një periudhë deri në 24 muaj, për një të ri të sapopunësuar.

(e) Masa 5: Krijimi i një mjedisi dhe hartimi i bazave ligjore për zhvillimin e kapitalit të rrezikut dhe “Engjëjve të Biznesit”

Mjetet nga kjo masë mund të shfrytëzohen edhe nëpërmjet Fondit të Investimeve Aksionare dhe Mezanin të krijuar nga Fondi i Inovacioneve dhe i Zhvillimit Teknologjik, me pjesëmarrje deri në 25% të vlerës së investimit nga fondet e veta të kërkuesit, por jo më shumë se 30.000.000 denarë. Mbështetja nëpërmjet Fondit të Investimeve Aksionare dhe Mezanin do të zbatohet nëpërmjet aplikimit dhe vlerësimit gjatë gjithë vitit.

Mbështetja nga kjo masë jepet për përgatitjen dhe realizimin e projekteve të zhvillimit teknologjik të kërkuesit, dhe i mbulon të gjitha kostot e pranueshme për financim sipas masave 1, 2, 3 dhe 4 të këtij programi.

Aplikuesi mund të përdorë mbështetjen financiare për një periudhë deri në 36 muaj nga dita e miratimit të projektit, me mundësi vazhdimi për maksimum 24 muaj.

Kjo masë nuk cenon kushtet për përdorimin e fondeve që Fondi Ekuiti dhe Mezanin i siguron nga burime të tjera financimi.

Masat nga Plani i Rritjes Ekonomike, Shtylla III, mund t'i nënshtrohen ndryshimeve të kushteve, sipas propozimeve dhe rekomandimeve të dala nga konsultimet me përdoruesit e mundshëm. Masat nga Plani i Rritjes Ekonomike, Shtylla 3 zbatohen nëpërmjet instrumenteve mbështetëse të mëposhtme:

- ✓ Grante të bashkëfinancuara për zhvillim teknologjik
- ✓ Grante të bashkëfinancuara për të përmirësuar inovacionin dhe
- ✓ Grante të bashkëfinancuara për përmirësimin profesional dhe praktikën e të rinjve të sapopunësuar
- ✓ Grante të bashkëfinancuara për zhvillimin teknologjik për tejkalimin e pasojave të krizës së COVID-19
- ✓ Grante të bashkëfinancuara për zhvillim teknologjik për rritje të përshpejtuar ekonomike

Kushtet e përdorimit, kriteret e përshtatshmërisë së aplikuesve, qëllimi i instrumentit mbështetës, shumat e mbështetjes, kushtet për bashkëfinancim, si dhe kushtet e tjera për secilin instrument të veçantë janë parashikuar në Rregulloren për instrumentin, dhe ato mund të jetë subjekt i ndryshimeve në varësi të propozimeve dhe rekomandimeve të marra nga sektori privat, si dhe nga faktorë të tjerë dhe partnerë institucionalë të Fondit.

- Mbështetje financiare për sektorin privat nëpërmjet Projektit për zhvillimin e aftësive dhe mbështetjen e inovacionit të financuar nëpërmjet një kredie nga Banka Botërore

Projekti për zhvillimin e aftësive dhe mbështetjen e inovacionit, i financuar nëpërmjet një kredie nga Banka Botërore, dhe i zbatuar nëpërmjet Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, synon të përmirësojë transparencën e shpërndarjes së burimeve dhe të avancojë llogaridhënien në arsimin e lartë, si dhe të përmirësojë rëndësinë e arsimit të mesëm teknik profesional, dhe përkrahja e kapaciteteve inovative në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Projekti, me një buxhet të përgjithshëm prej 17.7 milionë euro, përbëhet nga komponentët e mëposhtëm:

- 1) përmirësimi i transparencës së arsimit të lartë;
- 2) modernizimi i arsimit dhe aftësimit të mesëm teknik profesional dhe
- 3) përmirësimi i kapacitetit inovativ të sipërmarrjeve dhe bashkëpunimi me organizatat kërkimore.

Në kuadër të projektit, Fondi shfaqet si mbajtës i komponentit të tretë “Përmirësimi i kapaciteteve inovative të sipërmarrjeve dhe bashkëpunimi me organizatat kërkimore”, në kuadër të të cilit parashikohen këto aktivitete:

Nga buxheti total i projektit (17,7 milionë euro), buxheti për komponentin e tretë, bartës i të cilit është Fondi, dhe qëllimi i të cilit është mbështetja financiare e sipërmarrjeve në bazë të katër instrumenteve të renditura më poshtë, arrin në 9,159,750.00 euro.

Në kuadër të këtij komponenti të projektit, është siguruar mbështetje në segmentet e mëposhtme:

- ✓ Ndërtimi i kapaciteteve për Fondin e Inovacionit dhe të Zhvillimit Teknologjik

Përmirësimi i kompetencës institucionale të Fondit nëpërmjet: (a) planifikimit dhe hartimit të programeve, strategjive, operacioneve dhe procedurave të Fondit; (b) ofrimin e trajnimit për personelin; (c) përzgjedhjen e komitetit të investimeve dhe recensentëve; (ç) ofrimin e trajnimeve për sipërmarrjet që përdorin mjete nga Fondi dhe (d) zbatimin e një strategjie marketingu dhe komunikimi.

- ✓ Investimet financiare pilot që duhet t'i realizojë/dorëzojë Fondi

Sigurimi i mjeteve për të inkurajuar inovacionin nëpërmjet: (a) sigurimit të granteve të inovacionit për financimin e akseleratorit; (b) sigurimit të granteve të inovacionit për të financuar dëshmimin e konceptit të inovacioneve; (c) dhënies së granteve të inovacionit ose nënkredive të inovacionit për të financuar komercializimin e kërkimit dhe zhvillimit dhe (ç) dhënies së granteve të inovacionit për të financuar aktivitetet e zhvillimit të teknologjisë dhe absorbimin e teknologjive, për teknologji, produkte dhe procese të reja ose të përmirësuara.

Si rezultat i Projektit për zhvillimin e aftësive dhe mbështetjen e inovacionit, ne kemi zhvilluar dhe ofrojmë mbështetje financiare nëpërmjet 4 (katër) instrumenteve për të mbështetur sektorin privat:

- 1) grante të bashkëfinancuara për shoqëritë tregtare start-up dhe spin-of;
- 2) grante të bashkëfinancuara për komercializimin e inovacioneve;
- 3) grante të bashkëfinancuara për ngritjen, funksionimin dhe investimet e akseleratorëve teknologjik-afarist
- 4) grante të bashkëfinancuara për zgjerimin e teknologjisë.

Projekti për zhvillimin e aftësive dhe mbështetjen e inovacionit, i financuar nëpërmjet një kredie nga Banka Botërore, ka një afat kohor deri më 30 prill 2021. Pas përfundimit të projektit, instrumentet mbështetëse të zhvilluara nëpërmjet projektit mbeten si instrumente mbështetëse, që do të financohen nga Buxheti i Fondit.

- **Mbështetja e vetëpunësimit nëpërmjet zhvillimit të biznesit inovativ "INgroup"**

Iniciativa zbatohet nëpërmjet programit të vetëpunësimit në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe të Politikës Sociale dhe Agjencinë e Punësimit, për të mbështetur personat e papunë për të filluar biznesin e tyre. Fondi është i përfshirë në pjesën e identifikimit të ideve të biznesit



me potencial për rritje të shpejtë, të ashtuquajturat "InGrupa", të cilit i ofrojmë mbështetje mentoruese pas regjistrimit të sipërmarrjes. Qëllimi është të forcohen kapacitetet e këtyre start-up kompanive në mënyrë që të përgatiten për aplikim në thirrjet e hapura të Fondit.

- **Forcimi i kapaciteteve të Fondit nëpërmjet mbështetjes teknike nga Banka Botërore**

Fondi është përfitues i asistencës teknike "Innovation and Competitiveness Ecosystem TA", financuar nga fondi britanik "Good Governance and Investment Climate Reform- (GGICR)", dhe e njëjta sigurohet nga Banka Botërore. Qëllimi i asistencës teknike është identifikimi i aktiviteteve, me të cilat ekosistemi për inovacion dhe konkurrencë në nivel të sektorit privat do të jetë më efikas dhe konkurrues. Qëllimi i mbështetjes është të përfitojë ekonomia e Maqedonisë së Veriut, duke përmirësuar aftësitë inovative të kompanive, të cilat do të kontribuojnë në forcimin e rritjes ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës.

Ky synim më i gjerë do të arrihet nëpërmjet disa kanaleve:

1. Analiza e nevojshme për të parë se si të përmirësohen instrumentet e inovacionit dhe mbështetja institucionale (komponenti 1);
2. Përshtatja në hartimin e instrumenteve të inovacionit për t'u fokusuar në market failures (dështimet e tregut) dhe nevojat kritike të kompanive (komponenti 2)
3. Përmirësime në strukturat institucionale, kornizat ligjore dhe kapacitetet e institucioneve qeveritare, që i zbatojnë instrumentet mbështetëse (komponenti 2);
4. Përmirësimet në kornizën ligjore për kapitalin e rrezikshëm (Komponenti 3) dhe
5. Zhvillimi i një pipeline më të fortë kompanish, që kanë kapacitet për inovacione, dhe mund të përfitojnë nga instrumentet transparencë më të madhe, akses në informacion dhe angazhim qytetar (komponenti 4).

Si rezultat i asistencës teknike do t'i qasemi përshtatjes së instrumenteve ekzistuese për mbështetjen e sektorit privat, krijimit të mekanizmave të rinj mbështetës, ndër të cilët është zhvillimi i financimit - aksionar nëpërmjet krijimit të Fondit të fondeve. Njëkohësisht, asistencë teknike duhet të ofrojë udhëzime për organizimin efikas të kapaciteteve institucionale në mbështetje të sektorit privat.

- **Zhvillimi i masave dhe instrumenteve të reja në mbështetje të sektorit privat**

Përveç masave dhe instrumenteve ekzistuese, ne do të punojmë për zhvillimin e instrumenteve dhe masave të reja për të mbështetur llojet e mëposhtme të aktiviteteve, që synojnë mbështetjen e sektorit privat:

- Zhvillimi i aksioneve - financimi, gjegjësisht krijimi i kushteve për zhvillimin e kapitalit të rrezikshëm;
- Zhvillimi i programeve për të mbështetur investimet në start-up bizneset nga investitorët engjëj;

- Zhvillimi i programeve për mbështetjen e platformave "crowdfunding", me qëllim hapjen e kanaleve të reja për mbledhjen e kapitalit nga start-up bizneset;
- Zhvillimi dhe mbështetja e ekonomisë së gjelbër nëpërmjet financimit të aktiviteteve "Green deal" nga sektori privat;
- Zhvillimi dhe mbështetja e sipërmarrjes sociale;
- Zhvillimi i programeve për mbështetjen e sipërmarrjes së grave.

Në kuadër të veprimtarisë së tij, Fondi do të vazhdojë të ofrojë burime të reja financimi, me të cilat masat dhe instrumentet e reja për mbështetjen e sektorit privat do të ishin subjekt i zhvillimit.

## **SHTYLLA 2 - MBËSHTETJE PËR ZHVILLIMIN E BIZNESIT**

- **Asistencë teknike për aplikuesit dhe programi mentorimit për përdoruesit:**

Në kuadër të aktiviteteve tona, ne do të vazhdojmë të ofrojmë asistencë teknike dhe mbështetje për sektorin privat në fushën e shërbimeve të mentorimit, me qëllim ngritjen e mtejshme të kapaciteteve të sektorit privat. Mbështetja përbëhet nga dy pjesë:

- ✓ Asistencë teknike për aplikuesit:

Asistenca teknike për aplikuesit ofrohet gjatë fazës së aplikimit, gjatë së cilës sigurohen shërbime konsultimi për tema specifike që përcaktohen sipas karakteristikave të instrumentit mbështetës, për të cilin është publikuar një thirrje.

- ✓ Mbështetje mentoruese për përdoruesit e mjeteve

Pas nënshkrimit të marrëveshjes për mbështetje financiare me Fondin, dhe pas fillimit të zbatimit të projektit, nëpërmjet takimeve individuale konsultative, nevojat e secilit përdorues vlerësohen veçmas dhe sipas të njëjtit diagnostikim, përcaktohen fushat e trajnimit. Lista e fushave të mentorimit nuk është kufizuese, sepse ato zhvillohen sipas nevojave të kompanive dhe sipas praktikave të vendosura ndërkombëtare si dhe kushteve ekzistuese të tregut.

Mbështetja mentoruese ofrohet nëpërmjet mentorimit individual dhe trajnimeve në grupe.

- **Zhvillimi i një programi për mentorime "të drejtuar":**

Për të siguruar një nivel më të lartë të cilësisë së mbështetjes teknike që Fondi tashmë ofron për përdoruesit e tij dhe përdoruesit e mundshëm në të ardhmen, fushëveprimi i programit ekzistues të mentorimit do të rritet duke futur mbështetje për:

- ✓ aplikantët e refuzuar - ata që aplikuan për një nga instrumentet e Fondit, por projektet e tyre të propozuara nuk u miratuan për financim - në mënyrë që të përgatiten më mirë për një thirrje të mëvonshme, ose një lloj tjetër instrumenti në të ardhmen,
- ✓ dhe përdorues me rritje të shpejtë (scaleups) - një grup kompanish nga portofoli i përdoruesve të mbështetjes nga Fondi, që do të identifikohen si me rritje të shpejtë, me potencial të dëshmuar për zgjerim në tregjet e huaja - për të lehtësuar dhe përshpejtuar qasjen e tyre në treg jashtë vendit nëpërmjet trajnimeve të krijuara për nevojat e tyre.

- **INOVACIONI KORPORATIV**

Fondi do të fokusohet në zhvillimin e partneriteteve me sektorin e korporatave në vend, duke zhvilluar një program që do të ofrojë një model për zhvillimin e inovacionit për kompanitë e mëdha nëpërmjet bashkëpunimit me startapet dhe kompanitë e reja inovative, që zhvillojnë zgjidhje në sektorët në të cilët ato janë të pranishme, si fintek, telekomunikacioni, agritek dhe sektorë të tjerë që do të përcaktohen në bazë të nevojave të sektorit të korporatave. Fondi do të luajë rolin e lehtësuesit të procesit të lidhjes së kompanive tashmë të krijuara në industri, me kompani të reja që përpiqen të depërtojnë në të njëjtat tregje me zgjidhjet e tyre inovative.

## **PARTNERITETE**

Fondi do të mbajë dhe zhvillojë vazhdimisht partneritete të reja me disa institucione dhe organizata kyç që operojnë në sektorin e SMVM-ve dhe në sektorin e inovacionit, kërkimit dhe zhvillimit nëpërmjet organizimit të ngjarjeve informative, pjesëmarrjes në konferenca, seminare, debate dhe aktivitete të tjera.

Fondi do të vazhdojë bashkëpunimin me Zyrën e kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe kabinetin e zëvendëskryeministrit përgjegjës për punë ekonomike dhe për koordinim me departamentet ekonomike, në drejtim të zbatimit të Planit të rritjes ekonomike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ne do të punojmë në mënyrë aktive për krijimin e bashkëpunimit rajonal dhe partneriteteve lokale për të rritur transparencën dhe disponueshmërinë e instrumenteve dhe programeve të Fondit, për sa më shumë sipërmarrje inovative, si dhe për të rritur në përgjithësi lëvizshmërinë e qytetarëve.

- ✓ Bashkëpunimi me partnerët vendas:

Shoqata e Bankave të Maqedonisë:

Vazhdojmë bashkëpunimin me SHBM-në (Shoqata e Bankave të Maqedonisë) në bazë të një memorandumit të nënshkruar bashkëpunimi për aktivitetet që kanë të bëjnë me qëllimet e mëposhtme:

1. Inkurajimi dhe afirmimi i aktiviteteve me interes të përbashkët;
2. Promovimi i mundësisë së financimit dhe lehtësimit i qasjes në kapital të ndërmarrjeve mikro, të vogla, të mesme dhe kompanive fillestare;
3. Promovimi i inovacionit dhe i zhvillimit teknologjik në vend; dhe
4. Promovimi i rritjes ekonomike dhe i zhvillimit të qëndrueshëm duke inkurajuar kulturën e sipërmarrësisë.

Odat Ekonomike, Shoqatat e Biznesit dhe Shoqëritë e Biznesit:

Në kuadër të aktiviteteve të rregullta të Fondit, është planifikuar të forcohet bashkëpunimi me odat ekonomike, shoqatat dhe shoqëritë e biznesit të vendit me qëllim të:

- informimit të rregullt për aktivitetet e Fondit,
- bashkëpunimit në fushën e marrjes së propozimeve për nevojat e sektorit privat gjatë krijimit të programeve për mbështetjen e tij,
- informimit për rezultatet e thirrjeve,
- zhvillimit të ngjarjeve të përbashkëta me qëllim informimin e anëtarësimit për mundësitë e financimit nëpërmjet Fondit,
- aktivitetet e tjera që kanë të bëjnë me forcimin e dialogut me sektorin privat.

Asociacioni Startap i Komunitetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut STARTAP MAQEDONI

Me synimin e zbatimit dhe forcimit të bashkëpunimit të ndërsjellë, si dhe drejtimin e përpjekjeve tona drejt inkurajimit dhe afirmimit të fushave me interes të përbashkët, para së gjithash në fushën e aktivitetit inovativ dhe startap, ne vazhdojmë të avancojmë bashkëpunimin me Asociacionin e Komunitetit fillestar të aplikacioneve të Republikës së Maqedonisë së Veriut STARTAP MAQEDONI.

Bashkëpunimi i ndërsjellë do të synojë zhvillimin dhe avancimin e aktivitetit të inovacionit dhe komunitetit startap, me digjitalizimin e ekosistemit startap dhe të dhëna transparente të disponueshme. Pjesë e aktiviteteve të planifikuara në kuadër të këtij memorandumit janë përmirësimi i rregulloreve ligjore për kompanitë startap dhe afrimi i kompanive start-up me tregun e huaj.

Fondi do të krijojë dhe do të mbajë bashkëpunim me partnerë të tjerë vendor, institucione, shoqata, shoqëri, organizata, etj; në drejtim të arritjes së qëllimeve kryesore të Fondit dhe mbështetjes së zhvillimit të ekonomisë vendore.

Fakulteti i Filozofisë Shkup

Bazuar në Memorandumin e nënshkruar ndërmjet Fondit dhe Fakultetit të Filozofisë në Universitetin "Shën Kirili dhe Metodi" Shkup, bashkëpunimi do të vazhdojë, qëllimi kryesor i të cilit do të jetë avancimi i arsimit dhe futja e inovacioneve në procesin arsimor. Do të

punohet për të mbështetur eventet mësimore-shkencore që promovojnë konceptin e inovacionit në arsim, shkencë dhe shoqëri; si dhe ekspertizë profesionale dhe shkencore nga fusha e shkencave humane dhe sociale, për nevojat e Fondit të Inovacionit dhe të Zhvillimit Teknologjik.

Qendrat rajonale të biznesit në kuadër të Qendrave për Zhvillimin e Rajoneve Planifikuese:

Në bazë të një memorandumit të nënshkruar ndërmjet Fondit dhe Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale në kuadër të projektit "Zhvillimi i balancuar rajonal i qëndrueshëm gjithëpërfshirës", bashkëpunimi do të vazhdojë, me qëllimin kryesor të projektit zvogëlimin e dallimeve në zhvillim ndërmjet dhe brenda rajoneve planifikuese, gjë që do të kontribuojë në kushte më të mira jetese për të gjithë qytetarët. Me qëllim të nxitjes së zhvillimit të balancuar rajonal, Fondi do të fokusohet në rritjen e pranisë së tij dhe përmirësimin e qasjes në financa për përdoruesit e mundshëm jashtë rajonit të Shkupit, në 7 rajonet e mbetura planifikuese, nëpërmjet bashkëpunimit me zyrat ekzistuese të zhvillimit të rajoneve planifikuese, si p.sh. dhe hapja e qendrave Start-up në të gjithë vendin nëpërmjet modelit të konvertimit të objekteve të papërdorura shtetërore.

Maqedonia 2025

Fondi do të vazhdojë bashkëpunimin me "Maqedonia 2025", veçanërisht në fushën e organizimit dhe pjesëmarrjes në ngjarje të përbashkëta, si dhe ofrimin e ndihmës mentoruese dhe këshilluese për sipërmarrjet e Maqedonisë; organizimin e takimeve të biznesit (B2B) etj.

✓ Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë

Banka Botërore:

Bashkëpunimi me Bankën Botërore vazhdon edhe në të ardhmen në fushën e:

- "Projektit për Zhvillimin e Aftësive dhe Inovacioneve" (deri më 30 prill 2021) dhe
- "Innovation and Competitiveness Ecosystem TA"

Bashkëpunimi nuk kufizohet vetëm në këto dy segmente, dhe Fondi do të mbajë bashkëpunim strategjik me Bankën Botërore në fushën e ngritjes së kapaciteteve të institucionit, mbështetjen në zhvillimin dhe financimin e programeve për sektorin privat, veçanërisht në fushën e zhvillimit të ekuiti financimit të kapitalit të rrezikut dhe të ngjashme.

Delegacioni i Bashkimit Europian:

Për realizimin e aktiviteteve të mbështetjes së sektorit privat, Fondi vazhdon bashkëpunimin me Delegacionin e Bashkimit Europian, veçanërisht në pjesën e mbështetjes së sektorit privat

në realizimin e aktiviteteve që lidhen me "EU Green Deal", por edhe forcimin e kapacitetet institucionale të Fondit, për realizimin e aktiviteteve që lidhen me "Green deal".

Ne vazhdojmë të ofrojmë mbështetje për zbatimin e projekteve me shumë përdorues të financuar nga Bashkimi Europian, si: Projekti EU4TECH PoC Project dhe Research Infrastructure Roadmap

Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar:

Bashkëpunimi me Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar vazhdon edhe në periudhën e ardhshme, sepse nëpërmjet fondit britanik "Good Governance and Investment Climate Reform- (GGICR)" u financua asistencë teknike "Innovation and Competitiveness Ecosystem TA", qëllimi i së cilës është identifikimi i aktiviteteve me të cilat ekosistemi për inovacion dhe konkurrencë në nivel të sektorit privat do të bëhet më efikas dhe konkurrues. Qëllimi i mbështetjes është të përfitojë ekonomia e Maqedonisë së Veriut, duke përmirësuar aftësitë inovative të kompanive, të cilat do të kontribuojnë në forcimin e rritjes ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës.

Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC – Regional Cooperation Council) dhe Forumi Ekonomik Botëror (WEF – World economic forum)

Në periudhën në vijim, Fondi do të forcojë bashkëpunimin me Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (RCC – Regional Cooperation Council) dhe Forumin Ekonomik Botëror (WEF – World economic forum) në kuadër të "Innovation and Competitiveness Accelerator" nga Ballkani Perëndimor. Në kuadër të akseleratorit, Fondi, së bashku me përfaqësuesit ekonomikë nga Ballkani Perëndimor dhe përfaqësues nga RCC dhe WEF, do të vazhdojnë me aktivitetet në lidhje me "Regional Early Stage Innovation Funding Scheme", domethënë ngritjen e një skeme rajonale financimi për sipërmarrjet në fazat e hershme të zhvillimit. Në fakt, ky aktivitet është edhe pjesë e Planit të veprimit të MAP REA 2021-2024 në pjesën "8.1 Regional innovation", si pjesë e procesit të Berlinit për Ballkanin Perëndimor.

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP)

Bashkëpunimi i Fondit të Inovacioneve dhe të Zhvillimit Teknologjik, me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), i cili filloi në vitin 2020 me nënshkrimin e Memorandumit të Bashkëpunimit, do të vazhdojë edhe në periudhën e ardhshme 3-vjeçare. Është planifikuar vazhdimi i aktiviteteve të planifikuara duke forcuar aktivitetet inovative dhe futjen e proceseve inovative në sektorin publik, mbështetjen për rritjen e sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme, promovimin e modeleve kërkimore dhe menaxhuese efektive, si dhe rritjen e bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik, privat dhe atij joqeveritar. Të dyja institucionet do të vazhdojnë të mbështesin rritjen e kompanive mikro, të vogla dhe të mesme nëpërmjet zbatimit të zgjidhjeve dhe shërbimeve inovative; bashkëpunimi me ndërmarrjet vendore, në mënyrë që ato të arrijnë

qëllimet e tyre për zhvillim të qëndrueshëm së bashku me agjencitë e zhvillimit dhe institucionet publike; avancimi dhe promovimi i zhvillimit afatgjatë nëpërmjet përmirësimeve teknologjike dhe mbështetjes së zhvillimit të aftësive digjitale që duhet të kontribuojnë në krijimin e vendeve të reja të punës, si dhe përfshirjen e grave në shkencat teknike dhe natyrore dhe projektet komerciale për të mbushur boshllëqet gjinore në tregun e punës. Fondi dhe UNDP do të vazhdojnë të punojnë për të rritur ndërgjegjësimin për qasjet e reja inovative, përmirësimet teknologjike, transferimin e njohurive në industri të ndryshme dhe promovimin e kërkimit midis akademisë dhe sektorit privat.

### **Ambasada e Zvicrës:**

Me memorandumin e nënshkruar ndërmjet Fondit dhe Programit Zviceran për Ndërmarrësi (Swiss Entrepreneurship Programme – Swiss EP) të Ambasadës së Zvicrës në Maqedoninë e Veriut, bashkëpunimi do të vazhdojë, qëllimi kryesor i të cilit është mbështetja e zhvillimit të inovacionit dhe sipërmarrësisë në vend, forcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe sipërmarrësve, si dhe mbështetja individuale për ngritjen e kapaciteteve institucionale, të cilat janë aspektet kryesore të këtij memorandumi. E gjithë kjo do të zbatohet nëpërmjet një sërë aktiviteteve, si mbështetja mentoruese nga ekspertët, trajnimi për përgatitjen e modeleve të biznesit dhe strategjive të komunikimit, ofrimi i mbështetjes për engjëjt e biznesit dhe investitorët, si dhe vendosja e një sistemi për monitorimin e progresit të kompanive që punojnë në projekte inovative dhe aktivitete të ngjashme.

### **USAID:**

Fondi do të vazhdojë bashkëpunimin me USAID-in në drejtim të përmirësimit të ekosistemit të biznesit, mbështetjes së sipërmarrësisë dhe bizneseve startap, me qëllim forcimin e kapaciteteve të sektorit privat dhe rritjen e konkurrueshmërisë së tij.

Fondi do të nënshkruajë memorandume të reja bashkëpunimi për periudhën 2021-2023 me UNICEF-in dhe USAID-in për vazhdimin e bashkëfinancimit të programeve UpShift dhe Junior Achievement, si dhe për zgjerimin e bashkëpunimit nëpërmjet projekteve dhe programeve të reja.

### **Shteti i Izraelit**

Fondi vazhdon bashkëpunimin me shtetin e Izraelit nëpërmjet Ambasadës së Izraelit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Bashkëpunimi synon të përfshijë forcimin e bizneseve të Maqedonisë, veçanërisht të komunitetit startap të Maqedonisë, duke lidhur kompanitë izraelite dhe ato të Maqedonisë; organizimi dhe pjesëmarrja në ngjarje të përbashkëta; organizimi i takimeve të biznesit (B2B); ndihmë këshilluese dhe mentoruese; shkëmbimi i përvojave dhe njohurive ndërmjet biznesmenëve izraelitë, veçanërisht pronarëve të bizneseve

fillestare dhe përfaqësuesve të sipërmarrjeve të Maqedonisë; organizimi dhe realizimi i vizitave studimore të kompanive të Maqedonisë në Izrael; etj.

### **Partneritete të tjera:**

Në periudhën e ardhshme, ne do të identifikojmë në mënyrë aktive burime të reja financimi dhe partneritete për pjesëmarrjen dhe zbatimin e projekteve nacionale dhe shumënacionale. Fondi do të marrë pjesë aktive në ngjarjet e organizuara nga institucionet ndërkombëtare, dhe veçanërisht nga institucionet e Bashkimit Europian, përgjegjës për fushën e arsimit, shkencës, kërkimit dhe inovacionit, mbështetjen e sektorit privat si European Investment Bank, European Institute of Innovation and Technology, Joint Research Centre, DG Research and Innovation, European Research Foundation and Education, Audiovisual and Culture Agency.

### **SFIDAT TEMATIKE**

Inkurajimi i inovacionit në fushat prioritare të shkencës dhe të teknologjisë, por edhe të shoqërisë në tërësi, në pajtim me politikën dhe programet ndërkombëtare të miratuara si dhe legjislacionin ekzistues dhe Strategjinë e inovacionit është një nga prioritetet tona. Në fushën e mbështetjes së zhvillimit të biznesit nëpërmjet sfidave, Fondi do të ndjekë gjithashtu tendencat dhe angazhimet botërore të përcaktuara nga Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (Sustainable Development Goals-SDGs) [https://sdgs.un.org/#goal\\_section](https://sdgs.un.org/#goal_section).<https://sdgs.un.org/>

Bazuar në sa më sipër, gjatë viteve 2021-2023 Fondi do të krijojë thirrje publike për përzgjedhjen e zgjidhjeve inovative për sfidat në fushat e mëposhtme:

#### **1. Ekonomia e gjelbër**

Ekonomia e gjelbër ofron potencial për zhvillim të qëndrueshëm nëpërmjet rritjes që është rezistente ndaj degradimit mjedisor, dhe ndryshimeve klimatike dhe siguron furnizime me ushqim, ujë dhe energji për të gjithë njerëzit. Ai bazohet në gjashtë shtylla: ndryshimet klimatike; ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve; ekonomi rrethore; mbrojtjen e mjedisit; mbrojtja e ekosistemit; ruajtjen e ujit dhe parandalimin e fatkeqësive natyrore.

Duke kuptuar rëndësinë e zhvillimit të ekonomisë së gjelbër, Fondi do të vazhdojë me organizimin e sfidave që mundësojnë rritjen e punësimit dhe të të ardhurave nëpërmjet investimeve në zgjidhje dhe mjete, që do të sigurojnë reduktim të emetimit të gazrave dhe ndotjes, rritje të energjisë dhe efikasitet të burimeve dhe parandalimi i humbjeve në biodiversitet dhe mbrojtja e ekosistemeve.

#### **2. Sipërmarrësia sociale**

Në dekadën e fundit, sipërmarrësia sociale është njohur si një nga faktorët kyç për punësimin dhe riintegrimin e të papunëve që kanë mbetur pa punë për një periudhë më të gjatë kohore,



si dhe për punësimin dhe riintegrimin e personave që janë më pak konkurrues në tregun e punës në vendet anëmbanë Evropës. Sot, ka 2 milionë sipërmarrje sociale në Evropë, që përbëjnë 10% të të gjithë bizneseve në BE. Supozohet se në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ekzistojnë rreth 450 sipërmarrje sociale që janë të organizuara si organizata civile, shoqëri tregtare, sipërmarrje mbrojtëse, kooperativa, kompani jofitimprurëse dhe institucione mikrofinanciare.

Ne besojmë në mundësinë e zhvillimit të këtij sektori, veçanërisht duke pasur parasysh se kjo lloj sipërmarrësie ka potencial të madh për t'u marrë me punët dhe problemet ekzistuese sociale duke ofruar zgjidhje të reja dhe inovative, që shpesh përfshijnë grupe të marginalizuara në shoqëri.

Për të nxitur zhvillimin e këtij sektori, është planifikuar të organizohet një sfidë për sipërmarrjet sociale që do të ofrojnë zgjidhje inovative, që do të kenë një ndikim të rëndësishëm social.

### **3. Digjitalizimi i sektorit publik**

Digjitalizimi i shërbimeve publike është një proces që po merr vrull me rritjen e teknologjive të informacionit. Futja e shërbimeve publike digjitale mundëson transparencë, llogaridhënie dhe qasje të barabartë, më të shpejtë dhe më të lehtë në shërbimet publike për qytetarët dhe të gjithë faktorët përkatës. Sektori publik duhet ti kuptojë kërkesat dhe nevojat e qytetarëve dhe, nëpërmjet digjitalizimit, t'i integrojë ato në hartimin dhe ofertën e shërbimeve publike. Përveç përfitimeve ekonomike, në kushtet e pandemisë Kovid-19, digjitalizimi kontribuon drejtpërdrejt në mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve.

Duke e njohur rëndësinë e këtij segmenti, Fondi do të punojë në zhvillimin dhe zbatimin e sfidave të reja për digjitalizimin e sektorit publik, të cilat do të vazhdojnë përfshirjen e kompanive vendore me kulturë dhe kapacitet inovativ në përmbushjen e nevojave të sektorit publik dhe shoqërisë si një e tërë. Sfidat do të financojnë zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve digjitale, për nevojat specifike të sektorit publik dhe qytetarëve. Duke përfshirë sektorin publik si përdorues përfundimtar, kompanitë do të fitojnë një zgjerim të konsiderueshëm të tregut.

### **4. Agroteknologjia / Agri Tech**

Teknologjia bujqësore ose agroteknologjia i referohet përdorimit të teknologjisë në bujqësi, hortikulturë dhe akuakulturë për të përmirësuar rendimentet, efikasitetin dhe përfitimin. Agroteknologjia mund të përbëhet nga produkte, shërbime dhe aplikacione që rrjedhin nga bujqësia me qëllim të përmirësimit të proceseve të ndryshme të prodhimit.

Në kuadër të sfidave, ne zhvillojmë mundësi për zbatimin e praktikave inovative në prodhimin primar bujqësor dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe aplikimin e arritjeve të kërkimit shkencor në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

### **5. Zinxhiri i furnizimit/Supply chain**

Një zinxhir furnizimi përfshin marrëdhëniet e biznesit që ekzistojnë ndërmjet një kompanie dhe furnitorëve të saj, si dhe ndërmjet një kompanie dhe konsumatorëve të saj. Ai ndjek rrugën,

pra procesin nga krijimi deri te konsumatori përfundimtar. Optimizimi i këtij procesi çon në avantazhe konkurruese si reduktimi i kostove operative, përdorimi efikas i burimeve, shpërndarja më e shpejtë e produkteve dhe, rrjedhimisht, realizimi i të ardhurave më të larta. Kompanitë vazhdimisht, dhe veçanërisht në kohë krizash ekonomike, përballen me sfida të shumta që lidhen me zinxhirët e furnizimit. Synimi i sfidës që do të realizohet në këtë fushë është rritja e nivelit të shërbimeve, që kompanitë u ofrojnë konsumatorëve dhe ulja e kostove të tyre. Sfida do të synojë të mbështesë, para së gjithash, kompanitë startup, që do të ofrojnë produkte inovative të destinuara për shitje me pakicë.

### SHTYLLA 3 - EKOSISTEMI STARTAP

Analiza e portofolit të FIZHT dhe trendet në ekonominë vendore tregojnë se kompanitë fillestare janë bartëse të zhvillimit dhe inovacionit në Maqedoninë e Veriut. Mbi 50% e kompanive të mbështetura nëpërmjet instrumenteve të Fondit në periudhën 2017-2020 janë kompani të sapo themeluara me një vëllim total investimi prej 27 milionë euro.

Për shkak të kësaj, për herë të parë po prezantojmë një shtyllë të veçantë për startapet nëpërmjet së cilës do të zhvillojmë një strategji të veçantë, me qëllim rritjen e mbështetjes për inovatorët dhe inkurajimin e rritjes së numrit të bizneseve të reja, që do të kontribuojnë në stabilizimin dhe zhvillimin e ekonomisë së Maqedonisë. Qëllimi i këtyre aktiviteteve është pozicionimi i vendit si një qendër rajonale startup dhe një hab qendër (qendër rajonale), ku të rinjtë do të mund të realizojnë idetë e tyre të biznesit.

Ky synim do të arrihet nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme:

- **Startup Këshill** - themelojmë një organ të veçantë këshillues, qëllimi kryesor i të cilit është të përfaqësojë komunitetin startup, dhe të përfaqësojë interesat e tij në procesin e krijimit dhe zbatimit të politikave që duhet të kontribuojnë në rritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të ekosistemit fillestar të Maqedonisë. Detyra kryesore e Këshillit është të lokalizojë problemet dhe të propozojë zgjidhje që do t'i përgjigjen nevojave reale të sipërmarrësve, d.m.th startapeve. Këshilli do të jetë pjesëmarrës aktiv në krijimin e politikave të ardhshme në lidhje me këto kompani, do të propozojë masa që synojnë përmirësimin e organizimit të punës së sektorit publik dhe institucioneve, të cilat do të rezultojnë në procedura të thjeshtuara dhe shërbime publike më të mira, si dhe rekomandime për uljen e barrës dhe kostos për startapet me ndërhyrje në rregullativën ligjore dhe kornizën ligjore, me qëllim lehtësimin e aksesit në kapital dhe mobilizimin e tij.
- **Startup hab** - hapja e 5 qendrave në të gjithë vendin me ripërshtatje të objekteve tashmë ekzistuese shtetërore, që është pjesë e strategjisë afatgjatë të qeverisë për transformimin e këtyre objekteve të papërdorura. Qëllimi është që ato të rriten në

qendra rajonale startup, që do të ofrojnë hapësirë pune dhe një vend për rrjetëzim dhe shkëmbim përvojash për komunitetin e startapeve. Qendra e parë e tillë është fshati maqedonas në Nerez, i cili do të shndërrohet në një fshat Startup. Në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare, ky objekt do të shndërrohet në “fshatin e parë me nomad digjital” ose “startup fshat”, i cili do të përfshijë hapësirë për kompanitë e sapoformuara, programe mentorimi si dhe evente që lidhen me funksionimin e komunitetit startup. Për këtë qëllim tashmë është përgatitur një studim fizibiliteti dhe do të përgatitet një strategji për punë operative, si dhe një strategji për vetëqëndrueshmëri. Bazuar në përvojën nga ky projekt, në tre vitet e ardhshme do të hapen qendra të tilla startup rajonale në katër rajone të tjera, të cilat do të synojnë të nxisin zhvillimin lokal dhe sipërmarrësinë. Ky aktivitet duhet të kontribuojë edhe në zhvillimin më të mirë ekonomik rajonal në të gjitha rajonet planifikuese.

- **Partneritetet** - lidhjen e partneriteteve dhe bashkëpunimit me hab qendrat ekzistuese në të gjithë vendin për promovimin e aktiviteteve dhe programeve të FIZHT-it. Qëllimi është të ofrohet qasje më e lehtë në programet dhe aktivitetet e Fondit, për të inkurajuar më shumë kompani që të punojnë në projekte zhvillimore dhe inovative, dhe të aplikojnë për mbështetje financiare nëpërmjet instrumenteve të Fondit. Gjithashtu, në kuadër të këtij bashkëpunimi, programet tona arsimore dhe mentoruese do të jenë në dispozicion të një game më të gjerë të aplikantëve potencialë dhe kompanive vendore.
- **Programi i nomadëve digjitalë** - kjo përfshin lehtësimin e procedurave dhe veprimeve për qëndrim dhe punë në vend për sipërmarrësit nga jashtë, në mënyrë që t'i tërheqë ata të vijnë të punojnë dhe të jetojnë në Maqedoninë e Veriut, duke e pozicionuar atë si një destinacion tërheqës për biznes për shkak të vendndodhjes dhe kushteve të jetesës. Për këtë qëllim, Fondi me Ministrinë e Brendshme do të krijojë një grup pune që do të punojë për ndryshimin e Ligjit të të Huajve, i cili do të lejojë të ashtuquajturit "nomadë digjitalë", që do të plotësojnë kriteret e paracaktuara për t'u mundësuar qëndrimi dhe leja për të punuar. Ky program do të përfshijë mundësinë e marrjes së vizës online, procedura të thjeshtuara dhe ndihmë administrative. Tërheqja e talenteve të tilla do të ndikojë pozitivisht në ekonominë vendore, dhe do të mundësojë bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet sipërmarrësve të Maqedonisë dhe sipërmarrësve ndërkombëtarë.
- **Zhvillimi i një programi të ri mentorimi për 4 grupe të synuara** – në kuadër të programit të mentorimit prezantohen për herë të parë programe speciale të krijuara dhe të destinuara për grupe të ndryshme të synuara: përdorues të mundshëm, përdorues aktivë, aplikantë, projektet e të cilëve nuk janë miratuar për bashkëfinansim dhe përdorues me potencial për rritje të shpejtë. Pritet që një qasje e tillë e synuar do të rrisë cilësinë e shërbimeve të Fondit dhe cilësinë e projektpropozimeve të dorëzuara.

- **Ambasadorët startup** – krijimi një rrjeti të ambasadorëve startup, detyra e të cilëve do të jetë të promovojnë startpet e Maqedonisë në botë, dhe të mundësojnë qasje më të lehtë dhe më efikase në tregje të reja. Qëllimi është të ngrihen kompanitë vendase startup dhe produktet dhe shërbimet e tyre, si një produkt global, i cili do të rrisë konkurrencën e tyre dhe në këtë mënyrë do të rrisë shanset për sukses rajonal dhe global të kompanive vendore.
- **Akseleratorët e Qeverisë** – me fokus në programet për zhvillimin e inovacioneve në sektorin publik. Qëllimi i akseleratorëve qeveritar do të jetë organizimi i programeve akselerator dhe investimet për zhvillimin e digjitalizimit në sektorin publik.
- **Samiti startup** - Një herë në vit do të organizohet një samit dy ditor ku do të marrin pjesë lektorë vendas dhe ndërkombëtarë, dhe i cili do të fokusohet në tendencat lokale dhe globale në botën e startapeve, si dhe ato në vend. Ky event do të jetë një mundësi për të shkëmbyer përvoja dhe për t'i zbatuar ato në kompanitë vendore.
- **Shpërblime startup për sipërmarrësit dhe startapet më të mira** - për të nxitur konkurrencë më të madhe në mesin e komunitetit startup, dhe një rritje të numrit të projekteve të biznesit inovativ, Fondi do të organizojë një herë në vit dhënien e shpërblimeve të specializuara për bizneset e reja nga vendi, që kanë arritur rezultatet më të mira në vitin e kaluar.

#### SHTYLLA 4 – SISTEMI HELIKS TREFISH/KATËRFISH

Indeksi Global i Inovacionit (2020) e rendit Republikën e Maqedonisë së Veriut, në vendin e 35-të nga 39 ekonomitë europiane në vitin 2019, dhe në vendin e 57-të në mesin e gjithsej 131 ekonomive, që janë pjesë e Indeksit Global të Inovacionit në vitin 2020. Edhe pse ekonomia nacionale tregon progres të moderuar, sipas treguesve individualë, Republika e Maqedonisë së Veriut vazhdon të tregojë rezultatet më të dobëta në fushën e kapitalit njerëzor dhe hulumtimit. Rezultati për treguesin "Bashkëpunimi kërkimor ndërmjet universiteteve dhe industrisë" është veçanërisht i ulët, dhe është identifikuar si një nga pikat më të dobëta në ekosistem, duke e vendosur vendin në vendin e 112 nga 131 vende për këtë tregues specifik.

Për të vlerësuar gjendjen aktuale të ekosistemit nacional të inovacionit në vitin 2019, u përgatitën tre studime të qëndrueshmërisë të financuara nga BE-ja, në kuadër të projektit "Pëlhura e Inovacionit: Rruga drejt Forcimit të Ekosistemit Nacional të Inovacionit". Një nga këto studime, "Studimi i qëndrueshmërisë për krijimin dhe zbatimin e instrumenteve të politikës së inovacionit" synonte të analizonte masat mbështetëse ekzistuese dhe të identifikonte mbivendosjet dhe dobësitë në ekosistemin nacional të inovacionit. Mangësia kryesore ndërmjet masave për mbështetjen e inovacionit, kërkimit dhe zhvillimit është identifikuar në transferimin e njohurive ndërmjet sektorit publik dhe privat, si dhe në bashkëpunimin ndërmjet komunitetit akademik dhe industrisë. Në këtë drejtim, studimi konfirmon rekomandimet e OECD-së, për një qasje "hap pas hapi", duke filluar me ngjarje të shumta heliks të trefishtë, të ndjekur nga Kuponët e inovacionit për bashkëpunim në shkallë të

vogël dhe më pas me grante të konsiderueshme për bashkëpunim në projekte më të pjekura ndërmjet bizneseve dhe komunitetit akademik, për të cilin ka një interes të madh nga sektori privat. Studimi rekomandon gjithashtu që Fondi të marrë përsipër funksionin e lidhjes së Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe shkollave, universiteteve me sektorin e biznesit.

Për sa i përket performancës arsimore, sipas rezultateve të testit të fundit PISA në vitin 2015, Republika e Maqedonisë së Veriut është ndër vendet me arritjet më të këqija. Shteti është i parafundit nga të gjitha vendet pjesëmarrëse në anketë, që do të thotë se më shumë se gjysma e studentëve nuk zotërojnë aftësi bazë. Problemi me të vërtetë është urgjent se treguesit tregojnë se aftësitë e të rinjve në vendin tonë po përkeqësohen gradualisht, ndërsa në vendet e tjera të rajonit ato janë në rritje. Njëkohësisht, vendi përballet me një humbje të madhe potenciali dhe energjie krijuese, shkalla e së cilës rritet kur merret parasysh edhe problemi i "ikjes së trurit".

Hulumtimi nëpërmjet një metodologjie të bazuar në njerëz, i kryer në vitin 2019 nga FIZHT, tregoi se disa programe rinore në vend që kanë treguar rezultate pozitive janë pikënisje inkurajuese. Megjithatë, shumë prej tyre zbatohen në nivel projekti, gjë që paraqet vështirësi në drejtim të arritjes së ndikimit më të madh që do të nxiste ndryshime në nivel nacional. Është veçanërisht e rëndësishme të identifikohen problemet dhe mangësitë në sistem në mënyrë që të veprohet dhe të gjejnë zgjidhje, por është po aq e rëndësishme edhe njohja e shembujve pozitivë, praktikat më të mira dhe mësimet e nxjerra. Për të përmirësuar rezultatet e arritura nëpërmjet programeve rinore, si "UpShift", "Junior Achievement" dhe "Sfida për Kërkuesit e Rinj", nevojitet mbështetje sistematike gjithëpërfshirëse për të siguruar kohezion, konsistencë dhe qëndrueshmëri. Qasja e pamjaftueshme në informacion dhe mundësia për të identifikuar në mënyrë adekuate nevojat, dhe për të dëgjuar zërin e të rinjve dhe edukatorëve në këtë proces është gjithashtu një nga dobësitë më të rëndësishme të identifikuara të sistemit. Të rinjtë përballen me barriera sistematike për mirëqenien e tyre, dhe rrjedhimisht nevoja që qeveria, sektori privat, shoqëria civile, si dhe agjencitë nacionale dhe ndërkombëtare të mendojnë në mënyrë strategjike për të ardhmen e tyre, dhe t'i ndihmojnë ata të realizojnë potencialin e tyre.

Në botën e sotme të ndryshimeve të shpejta të teknologjisë dhe ekonomisë globale, ekziston nevoja reale për aftësi shumë të specializuara dhe fleksibël, por edhe kushte që nxënësit dhe të rinjtë t'i zhvillojnë dhe t'i zbatojnë ato në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm dhe transformues. Ndërkohë që sistemet arsimore dhe sistemet ekonomike përballen me probleme për të mbajtur ritmin me ndryshimin, nxënësit kanë nevojë për një arsim nga i cili mund të nxjerrin njohuri, vlera dhe përvoja të zbatueshme, dhe kompanitë kanë nevojë për transferimin e njohurive dhe teknologjive si dhe punonjës aftësitë dhe njohuritë e të cilëve do të të jenë në gjendje të kapin hapin e zhvillimit global. Masat e FIZHT-it që synojnë zhvillimin e burimeve njerëzore dhe sistemi heliks trefish/katërfish synojnë krijimin e një ekosistemi që plotëson këto nevoja.

Të gjitha masat e krijuara në drejtim të forcimit të burimeve njerëzore dhe ndërtimit të një ekosistemi inovativ heliks trefish/katërfish, do të synojnë një zhvillim social të qëndrueshëm dhe transformues në pajtim me tendencat bashkëkohore të zhvillimit global. Agjenda e gjelbër, digjitalizimi dhe kohezioni social janë prioritetet horizontale, që do të përfshihen në masat mbështetëse nëpërmjet përfshirjes së tyre në kriteret e vlerësimit, dhe do të merren parasysh gjatë hartimit dhe promovimit të të gjitha aktiviteteve të Fondit. Gjithashtu, do të ketë

aktivitete që synojnë promovimin e konceptit të "inovacionit të hapur" dhe përfshirjen aktive të qytetarëve në procesin e identifikimit të sfidave sociale dhe zbatimin e zgjidhjeve.

Pas miratimit të Strategjisë së specializimit të zgjuar, ne do të ndërmarrim iniciativa për të përshtatur masat mbështetëse me sektorët prioritarë të specializimit dhe për të identifikuar iniciativa të reja, sipas sektorëve prioritarë të përcaktuara.

## **ARSIMI DHE TRAJNIMI**

Në periudhën 2021-2023, Fondi do të veprojë në drejtim të ofrimit të mekanizmave të qëndrueshëm dhe një qasje sistematike në drejtim të identifikimit dhe përmirësimit të aftësive të të rinjve në parandalimin e ikjes së trurit. Fokusi do të jetë në nxitjen e inovacionit, kreativitetit, të menduarit kritik dhe aftësive të shekullit të 21-të:

- krijimi i një mjedisi stimulues intelektual dhe përgatitja e të rinjve për të ardhmen nëpërmjet aftësive për zgjidhjen e problemeve në kontekstin e një bote me ndryshime të shpejta;
- mbështetjen e mobilitetit ndërkombëtar dhe nismave ndërkombëtare rinore;
- mbështetje për sinergjinë ndërmjet fushave të ndryshme të arsimit dhe trajnimit;
- krijimi i një platforme që do të lidhë sektorin e arsimit, sektorin e biznesit dhe organizatat e shoqërisë civile;
- do të forcojmë zërin e rinisë.

### **1. Një sfidë për kërkuesit e rinj**

Nëpërmjet "Sfidës për kërkuesit e rinj", Fondi mbështet projekte kërkimore të bazuara në metodën shkencore, duke përfshirë aspekte të tilla si: puna në grup, gjithëpërfshirja, kohezioni social, etika e kërkimit dhe përfitimi socio-ekonomik. Ne vazhdojmë me zbatimin e "Sfidës për kërkuesit e rinj" dhe do ta avancojmë atë nëpërmjet prezantimit të "Research & Innovation Toolkits" dhe mentorimit në fazën e formulimit të një projekt-propozimi.

### **2. Mbështetja e programeve të suksesshme të arsimit global që inkurajojnë të menduarit kritik, inovacionin, kreativitetin dhe SHTIAM te nxënësit dhe të rinjtë**

Nëpërmjet mbështetjes së programeve të suksesshme arsimore globale, ne sigurojmë qëndrueshmëri në nivel nacional të programeve që bashkëfinancohen nga donatorë ndërkombëtarë, si dhe përfshirjen e nxënësve dhe të rinjve nga Maqedonia në nismat globale.

Fondi do të vazhdojë bashkëfinancimin e Junior Achievement dhe UpShift, si programe që nxisin sipërmarrësinë tek të rinjtë dhe kompetencat e stafit mësimdhënës nëpërmjet aplikimit të metodologjive moderne arsimore, dhe përvetësimit të përvojave praktike.

### **3. Krijimi i një programi praktik të sipërmarrësisë dhe mundësive në ekosistemin startup për nxënësit e shkollave të mesme.**

Nga viti 2021, Fondi do të nisë prodhimin e përmbajtjeve digjitale për mësimin sipërmarrës, të përshatura me kontekstin dhe kushtet arsimore nacionale, duke përdorur përvojat e bizneseve dhe sipërmarrësve vendor. Përmbajtjet do të zhvillohen si burime të hapura arsimore në pajtim me kurrikulën për vitet III dhe IV të arsimit të mesëm, dhe do të mundësojnë përfshirjen aktive të nxënësve të shkollave të mesme në sistemin fillestar.

### **4. Mbështetja e ekselencës shkencore-teknologjike, dhe sipërmarrësisë mes nxënësve dhe të rinjve**

Në varësi të rrethanave të shkaktuara nga Covid-19, në periudhën 2021-2023 do të testojmë masën për të mbështetur ekselencën shkencore dhe teknologjike, dhe sipërmarrësinë mes nxënësve dhe të rinjve.

Qëllimi i kësaj mbështetjeje është të identifikojë potencialin për përsosmëri dhe aftësi të nxënësve dhe të rinjve në shkencë, teknologji, inxhinieri, art, matematikë (në tekstin e mëtejshëm "SHTIAM") dhe sipërmarrësi, për të forcuar njohuritë dhe aftësitë e tyre në lidhje me bashkëmoshatarët e tyre në nivel botëror, t'u ofrojë të rinjve mundësi për të fituar përvoja ndërkombëtare, dhe të mësojnë nga bashkëmoshatarët e tyre në botë, si dhe t'u ofrojë atyre kushte për transferimin dhe zbatimin e këtyre përvojave, njohurive dhe aftësive në kontekstin më të gjerë shoqëror. Kjo masë do të financojë përgatitjen dhe pjesëmarrjen e nxënësve, nxënësve dhe të rinjve të Maqedonisë në garat dhe olimpiadat e themeluara ndërkombëtare.

Qëllimi i kësaj mbështetjeje është forcimi i kapaciteteve të nxënësve dhe të rinjve në drejtim të përfshirjes së tyre të mëtejshme në Qendrat e Ekselencës.

### **5. Platforma e rrjetëzimit, mobilizimit dhe racionalizimit të burimeve**

Nga viti 2021, fillojmë të zhvillojmë një Platformë që do të synojë të lidhë të rinjtë, mësuesit, prindërit, institucionet publike, sektorin civil, sektorin privat dhe donatorët në drejtim të rrjetëzimit, mobilizimit dhe racionalizimit të burimeve. Platforma do të mundësojë funksionalitete të tilla si financimi nga grupi, dhe ndarja e burimeve për realizimin më të lehtë të iniciativave kërkimore dhe inovative të nxënësve dhe të rinjve.

Zhvillimi i platformës do të fillojë me krijimin e një Regjistri Programesh, që do të prezantojë në një vend informacion mbi programet e kaluara dhe ekzistuese që nxisin kreativitetin, inovacionin dhe sipërmarrësinë tek të rinjtë, si dhe përvetësimin e aftësive për shekullin e 21-të. Një rishikim i tillë i nismave do të kontribuojë në një koordinim më të mirë ndërmjet institucioneve që mbështesin dhe zbatojnë programet, do të lehtësojë qasjen në informacion për palët e interesuara, duke rritur kështu vizibilitetin e programeve dhe duke ndikuar në zbatimin më të suksesshëm të tyre. Regjistri do të shërbejë gjithashtu si bazë për analiza të mëtejshme të programeve ekzistuese për të identifikuar praktikatat e suksesshme, por edhe mangësitë në mbështetjen.

Fillimisht është planifikuar që Regjistri i Programeve, të shërbejë si mjet për regjistrimin e programeve ekzistuese dhe nëse hulumtimet e mëtejshme tregojnë se një mjet i tillë përdoret nga palët e interesuara dhe është i nevojshëm formalizimi i tij, kjo bazë të dhënash do të shërbejë si bazë për krijimin e Regjistrimit të Unifikuar të programeve me formën, përmbajtjen dhe mënyrën e përcaktuar të realizimit, për të cilin do të propozohen ndryshimet dhe

plotësimet përkatëse në Ligjin e Veprimtarisë Inovative dhe do të hartohen aktet nënligjore përkatëse.

Regjistri i Programeve do të shërbejë gjithashtu si bazë fillestare e të dhënave që do të përdoret nga të gjithë aktorët (të rinjtë, mësuesit, prindërit, institucionet publike, shoqëria civile, sektori privat dhe donatorët). Për më tepër, kjo bazë të dhënash do të përmirësohet me informacione dhe funksionalitete që do të krijojnë një platformë për lidhjen e sektorit arsimor, sektorit privat dhe iniciativave civile.

## **BASHKËPUNIMI NDËRMJET KOMUNITETIT AKADEMIK DHE ATIJ SHKENCOR-KËRKIMOR ME SEKTORIN PRIVAT**

Një nga dobësitë e identifikuara të ekosistemit nacional të inovacionit është bashkëpunimi i dobët midis komunitetit akademik dhe industrisë, dhe mungesa e masave për të mbështetur transferimin e njohurive. Për të tejkaluar këto mangësi, në periudhën 2021-2023 planifikojmë të rrisim ndjeshëm mbështetjen në këtë drejtim nëpërmjet masave të mëposhtme:

### **MBESHTETJE FINANCIARE**

#### **1. Kuponët e inovacionit**

Kuponët e inovacionit përfaqësojnë një nxitje financiare që sipërmarrjet do ta përdorin për të mbuluar një pjesë të kostove të shërbimeve të ofruara nga institucionet akademike dhe kërkimore. Qëllimi i Kuponëve të inovacionit është të inkurajojë bashkëpunimin ndërmjet sipërmarrjeve dhe institucioneve akademike dhe kërkimore shkencore, në drejtim të zbatimit të aktiviteteve të inovacionit, në mënyrë që sipërmarrjet të rrisin konkurrencën e tyre. Fondi do të vazhdojë të zbatojë Kuponët e inovacionit që u pilotuan si masë në vitin 2020.

#### **2. Grantet bashkëpunuese**

Qëllimi i granteve bashkëpunuese është nxitja e bashkëpunimit ndërmjet sipërmarrjeve dhe institucioneve kërkimore, akademike dhe shkencore, në drejtim të transferimit të njohurive dhe transferimit të teknologjive, gjë që do të rrisë konkurrencën e sipërmarrjeve. Nëpërmjet kësaj mase do të inkurajohen aktivitetet kërkimore në institucionet akademike dhe kërkimore-shkencore, që kanë potencial të jashtëzakonshëm tregtar. Është planifikuar të testohet masa në vitin 2021.

#### **3. Mbështetje financiare për krijimin dhe zbatimin e praktikave inovative në bujqësi**

Në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, si pjesë e Programit të zhvillimit rural në vitin 2021, do të prezantohet një masë e re "Mbështetje financiare për ngritjen dhe zbatimin e praktikave inovative në bujqësi". Qëllimi i mbështetjes financiare të dhënë për krijimin dhe zbatimin e praktikave inovative në bujqësi është të inkurajojë transferimin e njohurive dhe/ose transferimin e teknologjive nga mjedisi akademik



në atë industrial, si dhe të modernizojë prodhimin primar bujqësor dhe përpunimin e prodhimeve bujqësore në drejtim të nxitjes së aktiviteteve inovative, dhe aplikimit të teknologjive të reja.

#### **4. Mobilitet të burimeve njerëzore shumë të kualifikuara: Mbështetje për angazhimin e magjistrantëve dhe doktorantëve në sektorin privat**

Kjo masë parashikon subvencionimin e tarifave për punësimin e magjistrantëve dhe doktorantëve në kompanitë. Qëllimi i masës është rritja e numrit të personelit të kualifikuar në fushat e shkencave natyrore dhe teknologjike, dhe inkurajimi i kërkimit të aplikuar në pajtim me nevojat e industrisë.

### **INFRASTRUKTURA E INOVACIONIT**

#### **5. Parku i Teknologjisë Shkencore dhe Zyra Nacionale e Transferimit të Teknologjisë**

Në vitin 2021, Fondi do të iniciojë ngritjen e Zyrës Nacionale për Transferimin e Teknologjisë, si një qendër që do të ofrojë shërbime dhe do të inkurajojë bashkëpunimin ndërmjet arsimit të lartë, institucioneve kërkimore-shkencore dhe industrisë. Zyra nacionale e Transferimit të Teknologjisë, do të ofrojë shërbime që lidhen me qasjen në financa, shërbimet ligjore dhe financiare, të drejtat e pronësisë intelektuale, menaxhimin e inovacionit dhe shërbime të tjera që lidhen me proceset e kërkimit dhe inovacionit në drejtim të transferimit të teknologjisë dhe transferimit të njohurive midis akademisë dhe sektorit privat.

Zyra Nacionale për Transferimin e Teknologjisë do të jetë bërthama për ngritjen e Parkut të parë të Shkencës dhe Teknologjisë. Parku i shkencës dhe Teknologjisë parashikohet si një organizatë komplekse që ofron infrastrukturë dhe mbështetje biznesi për kompanitë inovative në një vend. Në periudhën 2021-2023 parashikohet realizimi i fazës së parë të ngritjes së Parkut Shkencor dhe Teknologjik, që nënkupton përshtatjen dhe shndërrimin e një objekti ekzistues që ndodhet në kampusin e fakulteteve teknike të Universitetit “Shën. Kirili dhe Metodi” në Shkup.

#### **6. Qendrat e Ekselencës "FAB LABS".**

Me synimin për të krijuar kushte për studentët për të realizuar idetë e tyre teknologjike dhe sipërmarrëse nëpërmjet një procesi kërkimi, zhvillimi dhe inovacioni, Fondi do të fillojë një analizë të mundësive për krijimin dhe mbështetjen e Qendrave të Ekselencës në institucionet e arsimit të lartë.

### **SHTYLLA 5 – NDIKIMI I FIZHT**

- Analiza e portofolit të përdoruesve të Fondit nga sektori privat

Fondi do të vazhdojë të mbajë një bazë përdoruesish për programet e mbështetjes së sektorit privat, në mënyrë që të ketë një pasqyrë të portofolit total të Fondit sipas treguesve të ndryshëm:

- Pasqyrë e shumës totale të mbështetjes financiare nga Fondi
- Pasqyrë e shumës totale të financimit vetanak nga sektori privat
- Pasqyrë dhe analizë e përdoruesve sipas instrumentit mbështetës
- Pasqyrë dhe analizë e përdoruesve sipas burimit të financimit
- Pasqyrë dhe analizë e përdoruesve sipas madhësisë së tyre
- Pasqyrë dhe analizë e përdoruesve sipas rajoneve planifikuese
- Pasqyrë dhe analizë e përdoruesve sipas statusit të zbatimit
- Pasqyrë dhe analiza e përfaqësimit të grave si pronare/menaxhere në mesin e përdoruesve
- Pasqyrë dhe analizë e përdoruesve sipas industrisë
- Analiza e mbështetjes së sipërmarrjeve startup në raport me totalin e portofolit

Pasqyrë e totalit të portofolit të Fondit për mbështetjen e sektorit privat do të plotësohet në të ardhmen me tregues të rinj sipas nevojave të analizës së Fondit.

- Analiza e performancës financiare nga operacionet e përdoruesve të Fondit

Për të monitoruar lëvizjet në zhvillimin e sipërmarrjeve që marrin mbështetje financiare nga Fondi, do të vazhdojmë me aktivitetet e analizimit të operacioneve të përdoruesve. Qëllimi i analizës është të vlerësojë ndikimin e mbështetjes financiare nga Fondi në operacionet e sipërmarrjeve, si dhe një analizë e tendencave, pra ritmeve të rritjes midis përdoruesve sipas treguesve të përcaktuar si:

- Norma vjetore e rritjes së të ardhurave
- Norma e rritjes së fitimit të realizuar
- Pjesëmarrja mesatare e sipërmarrjeve fitimprurëse në portofolin total të Fondit
- Shkalla e rritjes së numrit të punonjësve
- Norma e rritjes së pagës mesatare të paguar
- Norma e rritjes së fondeve të derdhura në buxhet bazuar në tatimin mbi fitimin, kostot nga tatimet mbi pagat dhe kompensimet e pagave, dhe kontributet nga sigurimet sociale të detyrueshme.

Analiza e performancës financiare të përdoruesve mund të zgjerohet me tregues shtesë. Metodologjia e prodhimit mund të jetë analiza me thirrje, analiza me instrument mbështetës, analiza e punës së përfituesve të Fondit dhe krahasimi i rezultateve me aplikantët që nuk kanë marrë mbështetje nga Fondi, etj., të gjitha me qëllim të njohjes së efekteve nga përdorimi i mbështetjes financiare nga Fondi.

- Digjitalizimi i portofolit dhe aktiviteteve të monitorimit të përdoruesve

Me qëllim digjitalizimin e operacioneve, veçanërisht në pjesën e monitorimit të portofolit të Fondit si dhe monitorimit të përdoruesve, në kuadër të programit afatmesëm për periudhën 2021-2023, prokurimi/përpunimi i një mjeti/softueri plotësisht të digjitalizuar për monitorimin dhe ndjekjen e ecurisë së përdoruesve të FZHTI-së, si dhe ndjekja i portofolit të projekteve të mbështetura.

**Qëllimi i krijimit të tij buron nga nevoja për ekzistencën e një mjeti digjital, pra të një sistemi informacioni menaxhues nëpërmjet të cilit, në një periudhë shumë të shkurtër kohore, do të siguroheshin të dhëna që lidhen me: historinë e çdo përdoruesi të fondeve, fazën e realizimit të projektit, dhe të ngjashme. Krijimi i tij do të ishte i dobishëm në disa aspekte:**

- procesi i monitorimit të përdoruesve do të përshpejtohej ndjeshëm;
- duke mundësuar dukshmëri më të mirë të statusit të përdoruesve të FZHTI;
- ofrimin e informacioneve për Komitetin e Miratimit të Investimeve gjatë aplikimit të përdoruesve ekzistues për historinë, që ata kanë në FZHIT për një periudhë shumë të shkurtër kohore;
- ndarja e informacioneve me investitorët potencialë për statusin dhe historinë e një përdoruesi të caktuar në FZHTI, etj.
- monitorimi i automatizuar i portofolit të të gjithë përdoruesve të FZHTI dhe gjenerimi i raporteve për të njëjtat sipas treguesve të ndryshëm (industri, rajon, instrument, sasia e mbështetjes, etj.).

**Plani për zhvillimin e mjetit të monitorimit dhe ndjekjes të portofolit do të zhvillohet në disa faza:**

- shkëmbimi i ideve me të gjithë aktorët e brendshëm dhe të jashtëm në procesin e monitorimit;
- kontrollimi nëse ekziston një mjet i tillë ekzistues dhe mundësia e përshtatjes së tij për nevojat e FZHTI-së;
- nëse nuk ekziston, përpunimi i një mjeti krejtësisht të ri për përdorimin e Fondit.

## **MARKETINGU DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN**

Në pajtim me programin afatmesëm, Fondi do të zhvillojë një vizion, mision dhe markë të re. Për këtë qëllim po punohet në zhvillimin dhe promovimin e një identiteti të ri vizual (krijimi i logos dhe faqes së re) i cili duhet të jetë i njohur në publik. Në të njëjtën kohë, po zhvillohet një qasje e re multimediale në informimin e publikut dhe futjen e mekanizmave për komunikim të dyanshëm, i cili duhet të sigurojë një zbatim më të mirë të programit FZHTI, d.m.th. ndërgjegjësimin për rëndësinë e inovacioneve në biznes, rritjen e interesit për Instrumentet mbështetëse të Fondit, dhe përmirësimi i cilësisë së projekt-propozimeve që dorëzohen në thirrjet e hapura.

Ne gjithashtu po zhvillojmë një strategji afatgjate të re, për investim në sipërmarrës dhe në sektorin startup të Maqedonisë nëpërmjet shkëmbimit të njohurive dhe mësimëve të nxjerra nga ekspertët botërorë, si kontribut në rritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të tyre. Për këtë qëllim aplikohen sa vijon:

- FZHTI CLASSROOM - vebinare me tema të ndryshme që janë të rëndësishme për ekosistemin startup, ku ekspertët globalë nga markat më të mëdha botërore në fusha të ndryshme ndajnë përvojën dhe rekomandimet e tyre.

- FZHTI INTERVIEW - intervistë me sipërmarrës novatorë nga fusha të ndryshme për të motivuar aplikantët e rinj, veçanërisht të rinjtë për të filluar biznesin e tyre.
- FZHTI MASTERCLASS – prezantime nga sipërmarrës të markave të njohura.

Do të organizohet në mënyrë shtesë **Samiti vjetor startup** i cili do të fokusohet në trendet lokale dhe globale në botën e startapeve, por edhe në vend, dhe ku do të marrin pjesë lektorë vendas dhe ndërkombëtarë. Ky event do të jetë një mundësi për të shkëmbyer përvoja, dhe për t'i zbatuar ato në kompanitë vendore.

Për të inkurajuar një konkurrencë më të madhe në komunitetin e startapeve dhe një numër në rritje të projekteve inovative të biznesit, një herë në vit do të organizohet ndarja e **startup Shpërblimeve për startapet dhe sipërmarrësit më të mirë** nga vendi që kanë arritur rezultatet më të mira në vitin e kaluar.

Krahas organizimit të vazhdueshëm të eventeve informative, takimeve, konferencave dhe diskutimeve në panel, të cilat synojnë të kontribuojnë në një zbatim më të mirë të programit të Fondit dhe promovimin e instrumenteve, ato do të pasohen nga një paketë e veçantë multimediale me oferta video dhe foto për rritjen e shikueshmërisë së aktiviteteve dhe lajmeve nga Fondi, si dhe mundësia e mbulimit më të madh të audiencës.

Transparenca, llogaridhënia dhe komunikimi i dyanshëm janë një imperativ bazë në funksionimin dhe veprimin tonë. Njëpërmjet mekanizmave të prezantuar ne do të informojmë vazhdimisht publikun për procesin e financimit të kompanive vendase njëpërmjet instrumenteve dhe efekteve të tij, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për rolin e FZHTI-së, si institucion qendror për zhvillimin dhe zbatimin e politikës nacionale për inovacionet dhe teknologjitë, dhe në sistemin nacional të inovacionit, për të arritur përfitime sociale dhe ekonomike, si dhe për të garantuar transparencë dhe përgjegjësi për përdorimin e buxhetit të shtetit dhe parave të qytetarëve dhe taksapaguesve.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet **komunikimit me mediat**, pra ne do të përfshijmë median në të gjitha ngjarjet e organizuara nga Fondi, drejtpërdrejt njëpërmjet konferencave për shtyp ose informimeve, ose indirekt me njoftime për shtyp. Në ueb faqen e Fondit, e cila do të ofrojë informacione në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze, si dhe në profilet zyrtare në rrjetet sociale (Facebook, Twitter, Instagram dhe YouTube), do të vazhdojë informimi i vazhdueshëm për të gjitha ngjarjet e organizuara nga Fondi, ose ngjarjet në të cilat ai është i përfshirë, si dhe informacione rreth instrumenteve mbështetëse individuale dhe thirrjeve aktuale.

Do të punojmë aktivisht edhe në zhvillimin e sfidave dhe programeve të reja të destinuara për aplikimin e inovacioneve në media.

Të gjitha këto aktivitete do të synojnë të kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e inovacionit në biznes, rritjen e interesit për instrumentet mbështetëse të Fondit, dhe përmirësimin e cilësisë së projekt propozimeve.

## ORGANIZIMI

- **Proceset e tjera**

Për operacionet që do të realizohen në Fond do të mbahen sisteme adekuate dhe procese të përshkuara. Do të mirëmbahet sistemi i menaxhimit të bazës së të dhënave për përdoruesit e instrumenteve nga Fondi, dhe të sistemeve të tjera në pajtim me rekomandimet e Bankës Botërore. Në kuadër të Projektit të Bankës Botërore për Zhvillimin e Aftësive dhe Inovacionit, ofrohet mbështetje për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës operacionale të Fondit, duke përfshirë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit për menaxhimin e përditshëm të projektit, sistemin për menaxhimin financiar, aktivitetet e kontabilitetit dhe raportimin, aktivitetet lidhur me regjistrimin e përdoruesve, aktivitetet lidhur me paraqitjen e kërkesave dhe projekt propozimeve, aktivitetet që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe integrimin e bazës së të dhënave për projektet dhe përdoruesit, për vlerësimin e kërkesave dhe propozim projekteve, vizitat në terren dhe monitorimin e projekteve. Në bashkëpunim me konsulentin për operacione, Fondi do të planifikojë dhe hartojë programet, strategjinë, aktivitetet operative dhe procedurat.

Në periudhën e ardhshme trevjeçare, parashikohet ndërtimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm i kapaciteteve operacionale të Fondit, ndër të tjera, për menaxhimin mjedisor, ekspertizën ligjore në transaksionet financiare, vlerësimin e pronësisë intelektuale dhe menaxhimin e pronësisë intelektuale, si dhe monitorimin e rezultateve dhe vlerësimin mbi ndikimin e instrumenteve financiare.

### **MBIKËQYRJA DHE VLERËSIMI (monitorimi i përdoruesit)**

Në periudhën nga viti 2021 deri në vitin 2023, në pajtim me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në rregulloret e instrumenteve mbështetëse, është planifikuar të vazhdohet me monitorimin e ecurisë së projekteve në drejtim të zbatimit të aktiviteteve të planifikuara, dhe realizimit të kostove të parashikuara në pajtim me buxhetin e miratuar të projektit si dhe monitorimin e rezultateve të arritura pas përfundimit të projektit nëpërmjet dorëzimit të raporteve semestrale dhe vjetore.

Zbatimi i projekteve nga përdoruesit monitorohet nëpërmjet raporteve tremujore dhe përfundimtare, narrative dhe financiare të dorëzuara, si dhe nëpërmjet realizimit të vizitave në terren të paktën një herë në vit. Duke pasur parasysh numrin e madh të përdoruesve ekzistues, është planifikuar të ruhet praktika e angazhimit të firmave të revizionit të jashtëm (të përzgjedhura me tender), që marrin pjesë në procesin e monitorimit dhe ndjekjes së përdoruesve të fondeve në pajtim me rregullat dhe procedurat e FZHIT-it.

#### DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Ky Program afatmesëm i punës së Fondit për periudhën 2021-2023 hyn në fuqi në ditën e publikimit në tabelën e shpalljeve të Fondit, dhe do të publikohet pas marrjes së pëlqimit nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pjesa nr.

\_\_\_\_\_.2020, Shkup

Kryetarja e Këshillit drejtues  
të Fondit të Inovacioneve dhe të  
Zhvillimit Teknologjik

Monika Jovanova